

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 qershor 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 maj 2022;
2. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025;
3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat;
4. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021;
5. Shqyrtimi i Raportit të sistemit të menaxhimit të performancës dhe grantit të performancës për vitin 2020;
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje;
7. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, gjatë periudhës janar – qershor 2022;
8. Rishqyrtimi i vendimit nr. 95/22 i datës 28.4.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021;
9. Rishqyrtimi i vendimit nr. 96/22 i datës 28.4.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
10. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>PËR/ZA/TO:</b>	Kuvendin e komunës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Melihate Basholli Latifi <i>Melihate Basholli Latifi</i> Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Sekretarisë së kuvendit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 16.6.2022

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2022 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2023-2025 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Raportit dhe grantit të performancës për vitin 2020.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
5. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë gjatë periudhës janar – qershor 2022.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
7. Rishqyrtimi i vendimit nr. 95/22 i datës 28.4.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
8. Rishqyrtimi i vendimit nr. 96/22 i datës 28.4.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të plotësohet dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, të futet si pikë e rendit të ditës <Shqyrtimi i vendimit për anulim të konkurseve për drejtorë të shkollave>.*

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E IV E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 MAJ 2022**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Avdiu, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Mehulli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungoi: Gresa Muli.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** - lexoi para anëtarëve të kuvendit dispozitat e Rregullores të punës së kuvendit, lidhur me diskutimet, si dhe kërkoi që të respektohen këto dispozita ligjore ashtu që të jemi racional në kohë në mbledhjen e kuvendit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - pasi i përshëndeti të pranishmit tha se ne si anëtarë të këtij kuvendi të zgjedhur me votën e lirë nga qytetarët e komunës sonë, jemi të thirrur të ndihmojmë aty ku kërkohet ndihma jonë dhe të kritikojmë aty ku mendojmë që nuk është në dobi të qytetarit tonë po edhe të japim propozime e të orientojmë procese të drejta e në të mirën e përgjithshme pa dallim në baza partiake apo kombëtare, sepse të gjithë janë qytetarë dhe taksapagues të qytetit tonë. Taksa e qytetarit është obligim njerëzor dhe ligjor dhe duhet të orientohet në përmirësimin e jetës së qytetarëve sepse ajo grumbullohet në buxhet me qëllimin e shpërndarjes së drejt te qytetari dhe për krijimin e kushteve më të mira të jetesës së qytetarëve.

Me këtë fjalim timin besoj do të ndërrojnë qasje të gjithë skeptikët që po provojnë të krijojnë një atmosferë të rreme dhe të paqenë, duke provuar të vendosin rregulla të reja jodemokratike e me këtë edhe imponimin e heshtjes në vend të dhënies së impulsit të përqafimit të ideve kreative të bazuara në ligje, transparent dhe llogaridhënie. Të nderuar anëtarë të kuvendit, unë besoj dhe mendoj se edhe shumica e juaj po edhe e qytetarisë aktive të Komunës së Vushtrrisë në seancën e kaluar na gëzoi lajmi nga drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, mr. z. Alban Tahiraj se është publiku Lista e pronave komunale në ueb – faqen zyrtare të komunës, kërkesë kjo e kahershme e deputetëve. Përkundër faktit se lista është e prezantuar vetëm me elemente bazike dhe nuk ofron informatat e duhura ka vlerën dhe peshën e jashtëzakonshme edhe formale edhe juridike andaj e përgëzoi Kryetarin dhe drejtorin për këtë hap shumë pozitiv dhe i inkurajoj që të ndërmarrin të gjitha veprimet për plotësimin me të dhëna të nevojshme për këto prona e kjo mund dhe duhet të bëhet për interesin e përgjithshëm. Por, prezantimi i Listës së pronave komunale ka shpërfaq përveç tjerash edhe dyshime për prona të caktuara, unë kam hulumtuar në gjeoportalin disa mostra të pronave, të cilat janë në regjistrin e pronave komunale edhe pse nuk kam hulumtuar të gjitha sepse duhet kohë, por nga ato që kam arrit të hulumtoj ka rezultuar dhe kam ardhur në përfundim jo të këndshëm për faktin se:

- Parcela me nr.P-70202016-01815-0 Zona kadastrale Vushtrri në sipërfaqe të përgjithshme prej 2 ha e 57 ari e 28 m<sup>2</sup> e që në listë mban nr.53 nuk ekziston dhe nuk del pronë komunale në gjeoportalin zyrtar të RKS. Gjithashtu edhe Parcela me nr.P-70202016-01827-0 Zona kadastrale Vushtrri në sipërfaqe të përgjithshme prej 93 ari e 40 m<sup>2</sup> e që në listë mban nr.54 nuk ekziston dhe nuk del pronë komunale në gjeoportalin zyrtar të RKS.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit** - kërkoi nga Drejtoria e Inspektimeve që ndërmarrin masa ndaj tregtarëve të papërgjegjshëm të shpezëve afër tregut, të cilët po bëjnë prerjen e shpezëve dhe nuk po i largojnë mbeturinat dhe kjo po kundërmon me erë të rëndë dhe të padurueshme në tërë tregun, gjë për të cilën ka ankesa nga tregtarët dhe konsumatorët atje. Po ashtu kërkoi që të bëhet inspektimi i kushteve higjienike në të cilat po bëhet prerja e këtyre shpezëve, sepse kjo është duke rrezikuar në përhapjen e ndonjë epidemie. Mandej kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që të rregullohet trotuari përgjatë rrugës Vushtrri-Nedakoc, në të cilën asfaltimi ka përfunduar vitin e kaluar, ndërsa trotuari ka mbetur në gjysmë dhe kësisoj po rrezikohen qytetarët që kalojnë në atë rrugë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - pasi përshëndeti të pranishmit, në emër të grupit kuvendar të LVV-së deklaroi se dekoratat apo titujt e nderit që do të ndahen për këtë vit kalendarik, nuk i kanë kaluar filtrat e domosdoshëm ligjor të paraparë me legjislacionin në fuqi, e kësisoj nuk kanë kaluar as në Komitetin për Politikë dhe Financa. Kjo nuk është një praktikë e mirë dhe është jotransparente. Pastaj ngriti çështjen e anulimit të konkurseve në Drejtorinë për Shëndetësi, përkatësisht në QKMF, gjë për të cilën nuk janë respektuar ligjet në fuqi. Mandej kemi parë një konkurs për drejtor të QKMF-së i cili është shpallur, më tej është anuluar disa herë, pastaj është rishpall prapë dhe i cili ka lënë shije të keqe të ndërhyrjes brutale politike në përzgjedhjen e menaxherit më të lartë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Më herët kemi parë se është ndërruar ushtruesi i detyrës së QKMF-së me një zyrtar tjetër dhe më pas i njëjti ushtrues detyre tashmë është zyrtarizuar si drejtor i QKMF-së, pa asnjë kundërkandidat në procesin e intervistimit, si person i vetëm që bie në kundërshtim me normativat ligjore. Pastaj përsëriti se kishte kërkuar edhe në mbledhjen e KPF-së që të anulohen konkuret në fushën e shëndetësisë pasi që janë në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 07/2017 e që paraqesin shkelje juridike në procedurat e rekrutimit, konkretisht dispozitat ligjore të nenit 7 të udhëzimit, kërkojnë që anëtarët e komisionit intervistues duhet të kenë përgatitje superiore, por në realitet në njërin prej këtyre komisioneve anëtarët e tij kanë qenë me shkollë fillore ose të mesme dhe të cilët kanë vlerësuar në panel. Nuk

mund të flasim për një konkurs kur komisioni intervistues nuk ka përgatitje universitare, të vlerësojë me kompetencë në konkurse kaq të rëndësishme. Pastaj nuk mund të flasim për transparencë dhe barazi në rekrutim siç ka premtuar kryetari i komunës, përderisa e futni në komision vlerësues shefin e grupit kuvendar të partisë në pushtet. Kjo paraqet shkelje të rëndë të paanësisë në vlerësim dhe jo transparencë, kjo bie ndesh me atë që është premtuar apo ndoshta ajo që është premtuar në fushatë i takon vetëm fushatës sepse tani ka filluar një tjetër model i qeverisjes. Në këtë kontekst ceku se kryetarit të komunës i është dhënë mjaft kohë që të bëjë anulimin e këtyre konkurseve që përbëjnë shkelje ligjore. Për më tepër drejtori i QKMF-së është zëvendësuar fillimisht nga ish-pushteti me një ushtrues të detyrës, përkundër që performanca e ish-drejtoreshës ka qenë e pranuar nga të gjitha subjektet politike që janë ndërruar në pushtet gjatë kësaj periudhe kohore. Prandaj nuk është në rregull të ndërrohet dikush nga detyra siç ka qenë ish-drejtoresha e QKMF-së që ka treguar performancë të mirë dhe ka menaxhuar si duhet maksimalisht gjatë përballjes me pandeminë covid-19. Në këtë kontekst fjala është për daktoreshën znj. Luljeta Zahiti, të cilës i janë bërë të gjitha kombinacionet për ta eliminuar nga pozita e drejtoreshës. Në anën tjetër drejtorin që është përzgjedhur, i njëjti ndaj tij janë zhvilluar procedura disiplinore në kuadër të QKMF-së, kjo edhe për faktin se pajisjet mjekësore në vlerë prej 100,000.00 € për disa vite nuk ishin hy në funksion dhe personi që tani është caktuar si drejtor ka përgjegjësi se përse ato pajisje nuk kishin hy në funksion.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** – ngriti shqetësimin e banorëve të fshatit Dumnice e Llugës, konkretisht banorët përgjatë rrugës “Shefqet Isa” pyesin kryetarin e komunës se a është në projekt për këtë vit ndërtimi i kanalit të ujërave të zeza në gjatësi afërsisht 800 metra, edhe pse në tri mandatet e kaluara, ka qenë në projekt dhe se para dy viteve ishin sjellë gypat e kanalizimit, por dikush prej pushtetarëve të atëhershëm ka dhënë urdhër që ata gypa një të premtë të merren dhe të njëjtit janë vendosur në fshatin Pestovë. Shpresa e vetme e këtyre banorëve ka mbetur qeveria aktuale e komunës dhe banorët deklarojnë se heqin dorë nga kërkesat tjera infrastrukturore duke e priorizuar projektin e ujërave të zeza.

**Behar Duraku, anëtar i kuvendit**- pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se duke parë gjendjen e rëndë të krijuar njëherë nga Covid 19 dhe tashme krizën me çmimet enorme të produkteve me bazike, siç janë buka e çdo produkt tjetër, propozoi që të subvencionohen me nga 300 euro nënat lehona, të cilat janë me asistencë sociale. Kriza financiare i ka prekur të gjithë, mirëpo kategoria e cila është me e ndjeshme mendoj që është kjo kategori dhe si të tillë propozoj që edhe të përkrahët dhe t’ju dilet në ndihmë. Propozimi, të jemi të çartë është vetëm për këtë vit si ndihmë në këtë kohë krizash.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - tha se më të vërtetë konkurset e shpallura në shëndetësi përbëjnë një shqetësim për qytetarët dhe për anëtarët e kuvendit pasi ato karakterizohen me parregullsi. Ajo se çfarë kishte premtuar kryetari i komunës që 99 fije i ka të lidhura me qytetarët dhe 1 me subjektin e tij politik, në fakt nuk po del se është reale. Andaj kërkoi që këto konkurse të rishikohen dhe të njëjtat t’i shmangen parregullsive juridike.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - pasi i përshëndeti të pranishmit, njoftoi se këto ditë shumica e shkollave dhe organizatat e tyre sindikale, kanë mbajtur takime me anëtarësinë e tyre, ku është diskutuar një ofertë e bërë nga kryetari i komunës për realizimin e të drejtave të mësimdhënësve që dalin nga kontrata kolektive. Në ato takime është thënë se kryetari i komunës është zotuar që të realizojë një pjesë të obligimeve që i ka komuna e që dalin nga kontrata kolektive. Konkretisht pyeti kryetarin se cilat janë ato obligime që ka premtuar kryetari i komunës se do t’i realizojë, sa është kostoja e tyre dhe cili është afati kohor në të cilin do t’i realizosh këto obligime komunale. Pastaj ngriti çështjen e një trotuari në fshatin Stanoc i Epërm rr. “Dalip Maloku”, i cili nga qeveria

e kaluar ka qenë e planifikuar të rregullohet në gjatësi prej 2 km, ndërsa janë përfunduar vetëm 1 km trotuar, dhe kësaj pjesë kryesore është mbetur pa u realizuar aty ku ka qarkullim të madh të qytetarëve, nxënësve dhe punëtorëve, konkretisht ky projekt – trotuar ka mbetur në gjysmë, pjesa më e madhe e lagjeve që gravitojnë në atë rrugë, siç janë lagjet: “Prronaj, Bllaca, Ajvazi, Maloku dhe Haradinaj”. Lidhur me këtë ai pyeti qeverinë se a ka planifikuar që ky trotuar i mbetur përgjysmë të realizohet. Po ashtu në qeverisjen e kaluar kishte filluar projekti për ndërtimin e kanalizimit në lagjen “Ajvazi” që lidhet me kanalizimin kryesor në fshatin Stanoc i Epërm, aty është bërë vendosja e disa gypave, por nuk është bërë shpuarja e asfaltit kryesor në rr.” Dalip Maloku” që lidh fshatin Stanoc me fshatin Breznicë dhe kemi bllokim të kanalizimit dhe nëse në këtë rast nuk intervenohet shpejt në atë projekt do të shkojë dëm gjithë ajo punë e kryer deri më tash. Lidhur me këtë ai kërkoi që në një afat sa më optimal të intervenohet në marrjen e masave për mënjanimin e këtij problemi, duke u lidhur ai gyp me kanalizimin kryesor.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit** - ngriti shqetësimin e saj se edhe përkundër asaj që me aprovimin e Statutit të Teatrit të Qytetit, ku është bërë emërimi i këtij teatri me emrin e artistit Adem Mikullovcit, prapëseprapë në emërtimet dhe dokumentet zyrtare nuk po figuron emri zyrtar i teatrit, madje edhe shfaqjet kur mbahen apo konkurset brenda teatrit, asnjëherë nuk potencohet emri zyrtar Teatri i qytetit “Adem Mikullovcit”. E gjitha kjo po bëhet për qëllime politike, pasi që artisti Adem Mikullovcit në kohët e fundit të jetës së tij, ishte deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, i zgjedhur nga qytetarët e Republikës së Kosovës, ndërsa një jetë të tërë ia ka kushtuar kulturës shqiptare. Më tej kërkoi që pikat e planit të punës të Drejtorisë së Kulturës të realizohen, pasi shumë prej tyre nuk janë zbatuar. Pastaj shtoi se Drejtoria e Inspektiveve me datë 5.4.2022, ka marrë një vendim për ndalimin e reklamimit të mallrave në hapësirat publike në trotuar. Vendimi ka hyrë në fuqi më datë 12.4.2022, por pavarësisht kësaj asnjë veprim nuk është ndërmarr në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, në këtë rast bëhet fjalë për rrugët kryesore dhe sheshet.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - kërkoi nga kryesuesja e kuvendit, që ta respektojë Rregulloren e punës së kuvendit, për sa i përket diskutimeve, kjo për faktin se po tejzgjaten diskutimet shterpe, jashtë pikave të rendit të ditës dhe jashtë interesit të përgjithshëm.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** - duke ju referuar diskutimit të parafolësit të tij ceku se nuk ka gjë më të rëndësishme sesa uji i pijshëm për qytetarët dhe shtoi se kryetari aktual i komunës kishte premtuar që brenda afatit prej gjashtë muajsh do të bëjë zgjidhjen e problemit me ujë të pijshëm. Por edhe pas këtij afati nuk ka indikacione se do të ketë furnizim me ujë të pijshëm për vende ku janë bërë kyçjet. Pastaj gjatë kohës kur ishte drejtor i Shërbimeve Publike për 14 muaj kishte realizuar rreth 4000 kyçje në 23 fshatra, ndërsa 3000 prej tyre janë funksionale, 1000 prej tyre kanë probleme, në këtë kontekst shtoi se me disa shpenzime të vogla do të mund të vendosen pompat për të dërguar ujin e pijes nëpër ato fshatra ku procesi ka mbetur në gjysmë.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit sqaroi me sa vijon: buxheti i komunës të gjithë jemi dëshmitarë se është aprovuar me shumë vonesë dhe tani për më pak se një muaj është alokuar në komunë, dhe për këtë kemi vonesa në projektet siç është ai me ujësjellësin, që është duke u punuar në vendosjen e pompave, por edhe që problemi do të jetë me fshatrat që kanë lartësi gjeografike më të lartë në pjesën lindore të komunës, dhe për këtë ka filluar studimi i fizibilitetit për hartimin e një projekti detaj për procesin e shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit, sepse nuk ka rrugë zgjidhje pa ndërtimin e një bazeni tek vendi kodrat e Skoçnës për furnizimin e asaj pjese me ujë të pijes. Lidhur me vendosjen e mbishkrimeve zyrtare në tetarin e qytetit, sqaroi se mirë kishte me qenë që vendosja e atyre mbishkrimeve të bëhet në qeverisjen e kaluar kur edhe është bërë emërimi i Teatrit të qytetit “Adem Mikullovcit” dhe premtoi se kjo çështje do të përmbillet shumë shpejt duke i vendosur zyrtarisht mbishkrimet dhe emrin zyrtar të këtij

institucioni komunal. Sa i përket lirimit të rrugëve dhe shesheve nga shitësit e mallrave, njoftoi se inspektorati komunal i ka paralajmëruar këta shitës dhe shpejt do të ndërmerren veprimet e nevojshme. Lidhur me të drejtat sindikale që burojnë nga kontrata kolektive për mësimdhënësit, sqaroi se oferta e tij si kryetar komune është që të ofrohen ujdi gjyqësore, në mes të komunës dhe mësimdhënësve, ku komuna do kursente shpenzime gjyqësore rreth 200,000.00 €, por përfitues do të dilnin edhe vetë mësimdhënësit nga kursimi i shpenzimeve për avokat. Andaj oferta e tij është që në saje të ujdisë gjyqësore, të paguhen shpenzimet e shujtës, transporti i mësimdhënësve dhe pagat jubilarë, ndërsa sa i përket licencave të mësimdhënësve këtë të drejtë mësimdhënësit do të mund ta realizonin përmes procedurave gjyqësore. Sa i përket propozimit të anëtarit të kuvendit z.Behar Duraku, ceku se është propozim i arsyeshëm, ndërsa projektet nga investimet kapitale të mbetura nga qeveria e kaluar do të vazhdohen. Konkursët e shpallura nga komuna, nëse gjen se ka parregullsi të gjitha do të anulohen, kësaj nuk do të lejohet të bëhen padrejtësi në përzgjedhjen e kandidatëve për punë në cilindo sektor. Kur bëhet fjalë për titujt e nderit të ndara si dekorata, sqaroi se këtë të drejtë e ka pasur Komiteti për Politikë dhe Financa, 1/3 e anëtarëve të kuvendit dhe Kryetari i komunës për të bërë propozime, andaj konform rregullores këtë të drejtë e ka shfrytëzuar ai si Kryetar komune dhe vlerësoi se ka bërë një përzgjedhje të duhur për t'i bërë nder të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Në fund lidhur me pretendimin se në listën e pronave figurojnë numra të parcelave që në fakt kemi të bëjmë me parcela inekzistente, kërkoi nga Drejtoria e Kadastrit që të bëjë spastrimin e kësaj liste.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - pyeti kryetarin e komunës se me cilin zyrtar nga shoqata sindikale e arsimtarëve është takuar, që është keqkuptuar deklarata e kryetarit të komunës për ujdi gjyqësore nga kontrata kolektive.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - sqaroi se e ka takuar kryesinë e SBASHK-ut, në Vushtri në ç'rast i ka bërë me dije qëndrimin e tij.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - pyeti drejtorin e Drejtorisë së Prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit, përkatësisht kontratën për furnizim me material higjienik AK-Vushtri, data e nënshkrimit 23.5.2022, vlera e përgjithshme e kontratës 79, 987.00 €, të njoftohet Kuvendi i komunës se kush është përfituesi i kësaj kontrate.

**Hyda Dallku, drejtor i DP-së** - sqaroi se ky aktivitet i prokurimit ka përfunduar me sukses, dhe përfitues i kësaj kontrate është operatori ekonomik "Korabi Show 2" me pronar Nazmi Azemi. Kjo kontratë është lidhur konform ligjeve në fuqi dhe nuk është evidentuar asnjë lloj shkeljeje.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës** - duke ju referuar diskutimit dhe pyetjeve të anëtarit të kuvendit Sylejman Mehulli, ceku se shqetësimet që ai i shfaq në kuvend, nuk duhet të mbesin vetëm në kuvend, por ato duhet të adresohen tek organet e drejtësisë, dhe ai beson se asgjë nuk do del, por nuk i bënë nder askujt dhe parafolësit të tij të tentojë të ndërtojë narracione të rreme, gjoja për keqpërdorime. Më tej shtoi dhe vlerësoi që mos të detyrohet ai dhe qeveria e tij të paraqesin disa fakte dhe prova që e bëjnë të ndihet gogja keq, andaj kërkoi që seanca të rrjedhë sipas rendit të ditës dhe interesit të përgjithshëm.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** - tha se nëse nënkryetari i komunës ka diçka që din për dikë që bie në kundërshtim me ligjin është mirë që ato t'i adresojë tek organet dhe t'i shpreh publikisht, por jo të tentojë të kërcënojnë dhe shantazhojnë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - vlerësoi se për disa seanca më radhë drejtorët e drejtorive komunale, me diskutimet e tyre, kanë goditur anëtarët e kuvendit, duke prekur edhe sferën personale të tyre, pa e përjashtuar edhe vetë atë. Por ai paralajmëroi se nuk ka çmim që e blen atë dhe personalitetin e tij, nuk ka gjë që e frikëson dhe e shantazhon, nëse keni ndonjë gjë për të dhe për subjektin e tij politik e që nuk do të keni asnjëherë, është mirë që t'i publikoni. Më tej shtoi se



ai vetëm posedon vota sa subjektet të caktuara politike dhe nuk ka forcë që e zbrapsë në përfaqësimin e interesit të përgjithshëm qytetar, për të cilin e ka marrë votën. Nëse dikush dëshironi të futet në gjëra personale, atëherë këtë mund ta bëjmë jashtë kuvendit.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - duke ju referuar parafolësit të tij ceku se nuk ka arsye dhe as argumente, prandaj nuk nevojë për tensionim. Dhe shtoi se për të gjithçka që është e ligjshme është edhe e pranueshme, dhe ligjshmëria duhet të shikohet sepse shefi i grupit kuvendar të PDK-së, si anëtar i komisionit nuk ka shkuar si përfaqësues i kuvendit, por si zyrtar i QKMF-së, dhe nëse ligji ia lejon të jetë anëtar i kuvendit dhe zyrtar në QKMF, atëherë ai rrjedhimisht ka të drejtë të jetë pjesë e komisioneve të caktuara. Në këtë kontekst ai kërkoi që t'i kthehemi rendit të ditës dhe procedimit të tij dhe të lëmë mënjane polemikat dhe debatet shterpe.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:**

### **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14 prill 2022;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 prill 2022;
3. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve;
4. Shqyrtimi i raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2022;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Peticionit të përbashkët i banorëve të sheshit “Adem Jashari” dhe rrugës “Galip Badivuku” për largimin e trafos së rrymës nga sheshi.
9. Shqyrtimi i Peticionit të përbashkët të fshatrave Nedakoc dhe Pestovë për kundërshtimin e ndërtimit të një objekti që konsiderohet se cenon moralin publik;
10. Të ndryshme.

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14 prill 2022**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14 prill 2022.**

**2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 prill 2022**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 prill 2022.**

### 3. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - paraqiti sqarime lidhur me dekoratat-titujt e nderit që janë planifikuar të ndahen për nder të 17 qershorit “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, ku ceku se me kujdes është bërë përzgjedhja e personaliteteve që do të ndahen këto çmime apo titujt dhe beson se titujt e tillë do t’i bëjnë nder qeverisë komunale, kuvendit dhe gjithë qytetarëve. Në vazhdim ai paraqiti një ekspozitë dhe arsyetim të zgjeruar të propozimeve për dekorata dhe njoftoi se propozimet për këto dekorata janë bërë konform rregullores, andaj kërkoi që këtë propozim të aprovohej në mënyrë unanime.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - tha se Vushtrria vërtet ka fat që ka shumë personalitete me vlera të larta që meritojnë të dekorohen. Pastaj vlerësoi se si kuvend kemi bërë një praktikë të mirë për nderimin e ish-kryetarëve të komunës dhe shtoi se mirë kishte me qenë që votimi të bëhet në formë të ndarë për dekorata dhe mirënjohje.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - tha se për propozimin për ndarjen e dekoratave dhe titujve, duhet të kemi një trajtim të posaçëm për secilën propozim për titull ashtu siç edhe përcaktohet me rregullore. Sa i përket mirënjohjeve që janë gjithsej 8, mund të jepen propozime tjera nga anëtarët e kuvendit dhe kështu të shkohet me votim të fshehtë. Sa i përket titullit <Nderi i qytetit> njoftoi se grupi kuvendar i LVV-së propozon atdhetarin e çështjes kombëtare, kryetarin e parë të komunës pas luftës z.Xhemaj Pllanën, për këtë titull, ai arsyetoi se nuk duhet të prishet praktika e mirë që të nderohen me këtë titull ish-kryetarët e Komunës së Vushtrrisë, dhe shtoi se familja e z.Pllana është familje emblematike andaj meriton të nderohet.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - tha se propozimet për titujt e nderit janë bërë dhe atë sipas afatit të përcaktuar në rregullore, në këtë kontekst është konsumuar e drejta për propozime. Ai vlerësoi se pajtohet me propozimin e grupit të LVV-së, porse në këtë rast është e pamundur të bëhen propozime tjera.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - tha se propozimet për titujt e nderit janë proceduar me vonesë jo sipas afatit ligjor, dhe ceku se nga praktika e kaluar në kuvend, ka pasur raste pikërisht nga PDK-ja që gjatë seancës ka propozuar emra për titullin <Nderi i qytetit>. Në këtë kontekst ceku se është mirë mos të prishet radha për nderimin e ish-kryetarëve të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar nga ish-kryetari i parë i komunës z.Xhemaj Pllana.

**Në vazhdim kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 8 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” vendosi që votimi i titujve të nderit të bëhet me votim të përgjithshëm në pako.**

**Me 24 vota “për”, 3 vota “abstenim” kuvendi vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, me titullin **“Qytetar nderi”** i Vushtrrisë nderohen:

1.1.z.Arif Vladi-artist/këngëtar i njohur shqiptar;

1.2.znj.Liri Rasha-artiste/këngëtare shqiptare.

2. Dorëzimi i këtyre dekoratave-titujve do të bëhet nga Kryetari i komunës, më datë 17 qershor - “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Në rastin e shënimit të manifestimit “Ditët e Hasan Prishtinës”, çmimi “**Hasan Prishtina**” iu ndahet:

1.1 z. **Ali Januzi**, veteran i luftës së UÇK-së;

1.2 z. **Idriz Asllani**, veteran i luftës së UÇK-së;

1.3 z. **Ramadan Manovi**, veteran i luftës së UÇK-së.

2. Dekoratat nga pika një e këtij vendimi i dorëzon Kryetari i komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 10 qershor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Në rastin e shënimit të “Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë”, z. Bekim Shyti nga Vushtrria, ish-komandant i Njësisë Speciale të Zonës Operative të Shalës, i ndahet çmimi “**Emblema e Vushtrrisë**”.

2. Dekoraten nga pika një (1) e këtij vendimi e dorëzon Kryetari i komunës në ditën e shënimit të kësaj date, më 17 qershor 2022.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

1. Me këtë vendim, z. **Muharrem Shabani** nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet titulli “**Nderi i qytetit**”, për kontributin e tij dhënë për Vushtrrinë, si intelektual dhe si ish-kryetar i Komunës së Vushtrrisë.

2. Dorëzimi i këtij titulli do të bëhet nga Kryetari i Komunës më datë 17 qershor- “Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit**-propozoi për mirënjohje Gjevat Deliu, Shefqet Galicën dhe Sokol Braha.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - propozoi për mirënjohje Bedri Shalën i cili është mësues veteran arsimit, ka qenë komandant dhe njëri nga themeluesit e UÇK-së, si dhe Ahmet Morina, pjesëtar i orëve të para në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** - propozoi Ramadan Shaqirin që të nderohet me mirënjohje.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** -propozoi Blerim Zhabarin që të nderohet me mirënjohje për jetën dhe veprën.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** - propozoi Rasim Bajramin post-mortum që të nderohet me mirënjohje.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - propozoi Nazif Merovcin një hendbollist i dalluar që të nderohet me mirënjohje.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit** - propozoi Miran Hlilin që të nderohet me mirënjohje për jetën dhe veprën e tij.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - propozon Driton Zabërgjen që të nderohet me mirënjohje.

Kuvendi me vota “unanime” aprovoi formimin e komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për ndarjen e mirënjohjeve në përbërjen si në vijim:

Nurie Halili PDK;  
Edona Gashi LDK dhe  
Mek Selaci LVV.

**Pas zhvillimit të dy rundeve të procesit të votimit të fshehtë për ndarjen e mirënjohjeve kuvendit vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, Kuvendi i komunës për nder të “Ditës së Çlirimit të Vushtrisë”, më 17 qershor ndan këto mirënjohje:

**1.1 Blerim Zhabari - (post mortum)**, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, ish pjesëtar i UÇK-së dhe ish-punëtor i dalluar i administratës komunale në fushën e informimit publik;

**1.2 Miran Halili – (post mortum)**, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, ish- drejtor i administratës komunale;

**1.3 Habib Mustafa** - për kontributin e dhënë si veteran i luftës së UÇK-së, veteran i arsimit, profesor i historisë;

**1.4 Elvira Mazhiqi** - artiste në solo-këndim;

**1.5 Ali Jakupi - (post mortum)**, ish-ministër, profesor universitar;

**1.6 Ramadan Shaqiri- (post mortum)**, për kontribut për çështje kombëtare i martirizuar për lirinë e Kosovës;

**1.7 Bedri Shala-** veteran i arsimit, ish-komandant i UÇK-së, luftëtar i orëve të para në lutën e fundit;

**1.8 Nazif Merovci** - veteran i sportit, hendbollist i dalluar i viteve të 90-ta, i cili dha kontribut të çmuar për sportin vushtrrias;

**1.9 Shefqet Galica- (post mortum)**, veteran i arsimit, kontribues i çështjes kombëtare, pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981;

**1.10. Sokol Braha- (post mortum)**, veteran i arsimit, kontribues i çështjes kombëtare, pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981;

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit të komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

**Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me qarkoren buxhetore për vitet 2021-2022 dhe 2023.

**Pas shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” aprovoi raportin tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.**

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit paraprak për aprovimin e listës së veçantë që planifikohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2022

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - tha se kishte me qenë mirë që për t'i sqaruar gjërat për anëtarët e kuvendit, këtyre pronave t'i bashkëngjitet edhe një ortofoto, me qëllim që të dimë se ku gjenden këto prona. Tutje shtoi se edhe pse e ka përgëzuar drejtorin e kadastrit, për publikimin e listës së pronave, ai vlerësoi se publikimi i asaj liste të pronave ka qenë i ngutshëm, duke pasur parasysh faktin se në ato lista ka shumë gabime dhe ekzekutivi, por edhe kuvendi duhet të jenë të kujdesshëm që mos të krijojnë më shumë dëm sesa dobi prej punëve dhe veprimeve tona. Duhet pasur për bazë pronat që janë në komasacion, pronat që janë ndryshuar dhe nuk janë në pronësi të komunës, dhe kësaj duhet të bëhet një verifikim më i detajuar para se të bëhet publikimi. Aprovimit të këtij propozim-vendimi është dashur t'i paraprijë shpallja e një liste të veçantë të pronave në faqen zyrtare të komunës dhe prej asaj liste të vinë propozimet këtu në kuvend. Ai tha se nuk e ka gjetur listën e pronave në faqen zyrtare të komunës, ndoshta është shpallur në ndonjë vend special. Andaj nëse një listë e tillë nuk është publikuar në faqe zyrtare për pronat që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2022, atëherë procedimi i këtij propozim-vendimi nuk është bërë në formë të rregullt.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** - duke ju referuar pikës 1.13 të propozim-vendimit, konkretisht parcelës që gjendet objekti i vjetër i shkollës fillore “Migjeni” në Stanoc të Epërm i cili menaxhohet nga Komuna e Vushtrrisë, objekt i cili është dhënë në shfrytëzim nga komuna, vlerësoi se në këtë rast është bërë një gabim i madh, shkelje ligji, konkretisht është shkelur neni 1.6 i Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim i cili thotë: Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se, shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzojë

pronën vetëm sipas destinimit të pronës, duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi, andaj shtroi pyetjen se a e kanë respektuar këtë parim ata që e kanë votuar këtë vendim për dhënien e atij objekti në shfrytëzim. Ai dyshon se dhënia e asaj prone në shfrytëzim është karakterizuar me pazare dhe ryshfet nga qeverisja e kaluar, sepse ka pasur biznese aty afër që kishin mundur të merreshin në shfrytëzim. Kundërshtimin më të drejtë dhe më së mirë të këtij procesi e kishte bërë Ymer Haradinaj asamblist i LVV-së. Më tej shtoi se prona e komunës në fshatin Stanoc i Epërm është shpërdoruar nga gjithsecili dhe tani kemi mbetur pa pronë, e kjo ka bërë që mos të kemi pronë për vendosjen e objekteve me rëndësi vitale si çerdhe, shkollë apo shtëpi të shëndetit, andaj kjo është e papranueshme. Lidhur me këtë pronë ai propozon që këtij subjekti ekonomik t'i vazhdohet afati i shfrytëzimit edhe për një vit, më tej t'i gjendet një tjetër lokalitet për zhvillimin e veprimtarisë së biznesit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - njoftoi se me kujdes kishte kërkuar nga drejtori i Drejtorisë së Kadastrit që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër, ashtu që të spastrohet kjo listë nga disa defekte. Për më tepër shtoi se pronat që planifikohen të jepen në shfrytëzim duhet të jenë të lira, ato nuk gutojnë të jenë të uzurpuara, nuk duhet të ketë ndërtime tjera, duhet të ketë definim të qartë të pronësisë mbi ato prona, në rastin tonë ky propozim-vendim karakterizohet me shumë defekte, ku në listë figurojnë prona që me kulturë janë rrugë, varreza e të ngjashme. Nëse vazhdohet kështu me këtë qasje, do të rrezikohet komuna, sepse ata që i marrin këto prona në shfrytëzim do mund ta padisin komunën për mosmundësi të shfrytëzimit të lirë të pronave dhe të pasojnë shumë procese gjyqësore, ku komuna do të humb siç edhe ka ndodhur së fundi në rastin e Bedri Shabanit ku komuna ka humbur qindra mijëra euro, dhe shumë zyrtarë komunal bartin përgjegjësi në këtë proces. Pastaj në këtë listë të propozuar figuron një parcelë me numër 51 në fshatin Kollë ku në sipërfaqe prej 1 hektar janë varreza, mandej kemi rrugë siç është rasti me rrugën "Ilaz Kolla". Mandej në fshatin Bukosh kemi dy raste, pika 1.10 e propozim-vendimit, në këto prona kemi ndërtime, ku aty jetojnë familje, madje aty është rruga "Legjendarët e UÇK-së" që figuron në po këtë listë. Andaj kërkoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër dhe lista të procedohet e spastruar vetëm me prona reale që mund të jepen në shfrytëzim.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - propozoi që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër, më përjashtim të pikës 1.13 të këtij propozimi, ku bëhet fjalë për ish-objektin e shkollës në fshatin Stanoc i Epërm, dhe inkurajoi kryetarin e komunës që të vazhdohet me dhënien edhe të objekteve tjera të lira për veprimtari biznese. Më tej njoftoi se për këtë pronë që u apostrofua nuk ka pasur votim në kuvend, pasi që bëhet fjalë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër deri në një vit dhe këtë të drejtë e ka kryetari i komunës për të lidhur kontratë.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** - tha se ka pasur shkelje ligjore në rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës-objektit të shkollës në fshatin Stanoc i Epërm, sepse nuk është përmbushur kriteri buxhetor prej 10% i participimit siç parashihet me ligj.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - sqaroi se nuk ka shkelje ligjore, në rastin që po pretendohet, kjo për faktin se nuk ka pasur negociim direkt nga ana e kryetarit të komunës atë kohë, por ai objekt është dhënë në shfrytëzim për më pak se një vit, me kërkesën e palës, adresuar drejtorisë kompetente dhe me kontratë të lidhur nga kryetari i komunës.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** - tha se meqë ka paqartësi të mëdha sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, edhe ai është i mendimit që kjo pikë të shtyhet për njërin nga seancat e radhës, pasi të qartësohet shumë aspekti i kësaj çështjeje. Për më tepër kuvendi ka ngritur një komision për verifikimin e pronave, dhe është mirë që ky komision të bëjë verifikimin e këtyre pronave dhe kësajsoj kuvendi do ta ketë më lehtë të japë këto prona në shfrytëzim.

**Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit** - tha se sot ka pritur që në agjendë të kuvendit të jetë propozimi për shfuqizimin e vendimit me numër 81/21 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim në Zonën Ekonomike në Lumadh, andaj kërkoi sqarim nga kryesuesja e kuvendit se përse kjo pikë nuk është futur në rend të ditës. Po ashtu kërkoi që të zbatohet dhe respektohet Rregullorja e punës së kuvendit që ka të bëjë me diskutime pasi që anëtar i kuvendit nuk mund të diskutojë dy herë për të njëjtën pikë të rendit të ditës. Sa i përket propozim-vendimit për aprovimin e listës së pronave për dhënien në shfrytëzim Nisma-Socialdemokrate e mbështet në plotëni pa kurrfarë rezerve. Kjo për arsye se këto prona nuk po jepen menjëherë në shfrytëzim, por vetëm lista prioritare, e më tej komisioni enkas për këtë çështje do ti përgatitë procedurat tjera për pronat dhe do t'ia propozojë kuvendit për aprovim. Lidhur me pikën 1.13 të propozimit që flitet për objektin në fshatin Stanoc i Epërm në sipërfaqe prej 845 m<sup>2</sup>, dhe për këtë pronë kryetari i komunës i është drejtuar me shkresë AKP-së dhe MAPL-së për interpretim ligjor dhe në bazë të përgjigjes konstatohet se objekti në fjalë është në pronësi të komunës, ndërsa parcela është pronë e AKP-së, duke marrë për bazë këto fakte i propozoi kryetarit të komunës që të zhvillon negociata me AKP-në për këmbimin e kësaj prone, ndërsa investitori të vazhdojë veprimtarinë e tij deri në gjetjen e një zgjidhjeje përfundimtare.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - lidhur me objektin e shkollës në fshatin Stanoc i Epërm, i cili i është dhënë në shfrytëzim një operatori ekonomik, është bërë pa marrëveshje me banorët lokal, pa marrëveshje me Këshillin e fshatit dhe pa dëgjim publik, duke mos respektuar petitionin të cilin e kanë nënshkruar 510 banorë të fshatit Stanoc i Epërm, duke mashtruar opinionin publik me pretendimin se do të ngritët një fabrikë ku do të punësoheshin 60 deri 100 punëtorë. Me shumë bujë e pompozitet është thënë se dikush po del kundër punësimit, jo as atëherë as tash dhe asnjëherë nuk janë kundër punësimit, dhe shtoi se kjo pikë e rendit të ditës nuk është dashur fare të vijë këtu, sepse është kompetencë ekskluzive e kryetarit të komunës, prandaj ky i fundit është dashur të vendos shumë më herët, sepse kontrata kompanisë <Vitex> i ka skaduar në mars të këtij viti. Kjo kompani në objektin e shkollës është duke punuar në mënyrë ilegale, është thënë se do të punësohen 60 deri 100 punëtorë, andaj për këtë kërkoi nga personat përgjegjës të sillen kontratat dhe emrat e punëtorëve. Lidhur me këtë ai ka informata se në këtë fabrikë janë të punësuar 5 gra dhe për dy muaj rresht nuk kanë marrë pagë dhe trajtohen në mënyrën më të keqe të mundshme. Në fund kërkoi nga kryetari i komunës, që të dalë në terren, të konsultohet me banorët lokal, me këshillin e fshatit, të zhvillojë negociata dhe në fund të merret një vendim i drejtë i arsyeshëm dhe në interes të përgjithshëm.

**Mensur Kasumi, anëtar i kuvendit** - tha se e ndan mendimin me kolegët e tij parafolës, që ai objekt nuk i plotëson kushtet të jetë fabrikë, dhe shtoi se ka pasur premtime që ai objekt të shndërrohet në çerdhe publike për banorët e fshatit Stsanoc i Epërm, si fshati më i madh i Komunës së Vushtrrisë, andaj kërkoi që operatorit ekonomik t'i shkëputet kontrata dhe ai objekt të shndërrohet në çerdhe sipas kërkesës së banorëve të fshatit Stanoc i Epërm.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - vlerësoi se në saje të diskutimeve të anëtarëve të kuvendit shihet se është kërkesë që kjo pikë të shtyhet për ndonjë mbledhje të ardhshme, me qëllim të mënjanimin të defekteve që u evidentuan. Pikë referente është edhe objekti i shkollës në fshatin Stanoc i Epërm, për të cilin informoi se nëse ka bazë ligjore, kishte premtuar se do të ndërpritet kontrata. Më tej shtoi se nuk do të hynë në negociata për këtë kontratë pasi që kjo e drejtë e kryetarit të komunës është konsumuar dhe kontrata operatorit ekonomik i ka skaduar më datë 28.2.2022. Lidhur me këtë çështje i janë adresuar me shkresa AKP-së dhe MAPL-së për opinion, të cilët kanë vlerësuar se komuna ka të drejtë të japë në shfrytëzim objektin e shkollës pasi që është pronë e komunës. Për ta konstatuar gjendjen faktike është ngritur një komision, i cili ka ofruar raport me shkrim ku

gjen se në atë objekt janë bërë investime dhe punësime. Lidhur me këtë problematikë propozoi që të ngritet një komision miks mes kuvendit dhe qeverisë që do të bënte evidentimin e gjendjes atje për gjitha çështjet si për investimet, punësimet dhe kontratat, dhe më pas të silltë kjo çështje në kuvend. Ai potencoi se nuk e ka ndërmend të lidhë kontratë njëvjeçare me atë operator ekonomik, por nëse kuvendi vlerëson pozitive dhënien e pronës afatshkurtër do të jetë e mirëseardhur, por nëse vlerësohet e rrugës shkëputja e kontratës, ai do të ishte dakord. I njëjti komision të trajtojë edhe çështjen e një objekti dhe peticionin nga banorët e fshatit Pestovë-Nedakoc.

**Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-së** - në adresimin e tij para kuvendit sqaroi se, Ligji për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim, obligon komunën të bëjë publikimin e dy listave të pronave në faqen zyrtare të komunës - listën e përgjithshme dhe listën e veçantë. Tutje shtoi se qeveria e kryetarit Idrizi, prioritet e ka respektimin e ligjit dhe rendit, nuk ka plane tjera, dhe ajo është duke i përmbushur obligimet që dalin nga ligji. Për ta kristalizuar edhe më tepër këtë ai sqaroi se ajo nuk është e ndikuar nga palët e treta për faktin se ato nuk presin tek dera e qeverisë dhe Drejtorisë së Pronës, se cila pronë po kalon e cila jo, duke shtuar se ne nuk kemi obligime të tilla, kemi obligime ligjore e qytetare ashtu edhe siç është vepruar për këta gjashtë muaj qeverisjeje. Pastaj lexoi para kuvendit dispozitat e ligjit që rregullojnë fushën e dhënies së pronës në shfrytëzim që kanë referencë publikimin e listës së pronave. Duke polemizuar me anëtarin e kuvendit Adnan Lahu, shtoi se ai për një mandat të plotë nuk kishte arritur të publikonte listën në fjalë, ndërsa tani lista është publikuar nga ana e tij për më pak se gjashtë muaj kohë, andaj ky sukses i tij e ka shtangur ish-drejtorin. Në fund sqaroi se obligimi ligjor i publikimit të kësaj liste të pronave rrjedh deri më datën 31 mars të vitit kalendarik, porse në rastin konkret ky afat është vazhduar për shkak se viti 2021 ka qenë vit elektorale, por e njëjta me shkresë zyrtare është mundësuar që të zgjatet afati ligjor nga MAPL-ja.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - kërkoi nga Drejtori i Kadastrit që të flasë pa emocione dhe të mësohet të pranojë kritikën atëherë kur gabon. Tutje lexoi nenin 13 të Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, i cili thotë: Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës 1. Komuna duhet të publikojë listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës. 2. Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbajë këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Më tej ai insistoi se ajo listë nuk është sjell në kuvend, lista e pronave komunale që duhet të jepet në shfrytëzim brenda vitit kalendarik.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se e përgëzon drejtorin e kadastrit për punën e shkëlqyer që ka bërë deri tani, por ai kishte kërkuar miqësisht që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër, derisa të mënjanohej disa defekte, përndryshe procedura që është ndjekur për publikimin e listës është perfekt.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës** - tha se pjesët e propozimit për dhënien e pronës në shfrytëzim ku janë identifikuar të meta mund të hiqen nga vendimi, ndërsa pjesa tjetër mund të procedohet dhe aprovohet sot. Ndërsa pjesë të pronave ku mund të ketë uzurpime mund të obligohen palët të shikojnë sa a ka pengesa para se të marrin në shfrytëzim atë pronë.

**Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-së** - sqaroi se në këtë propozim-vendim janë gjithsej 18 parcela që do të jepen në shfrytëzim, ndërsa lista përsëriti se është obligim ligjor që të publikohet, por në këtë rast nuk po jepen në shfrytëzim këto prona, por vetëm po publikohen, ndërsa për më shumë më këto procedura do të merren komisionet gjegjëse, që do të kenë për detyrë shpalljen e ankandëve, inspektim të pronave se a janë të lira për t'u dhënë në shfrytëzim. Në të kundërtën



deklaron me sinqeritet se asnjëlloj detyrimi nuk kanë ndaj dikujt, por vetëm përmbushjen e kërkesave të ligjit.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit**-vlerësoi se sa i përket dhënies në shfrytëzim të objektit-shkollë në Stanoc të Epërm, kryetari aktual i komunës nuk ka asnjë lloj përgjegjësie juridike, sepse është dhënë më herët kjo pronë në shfrytëzim. Por tani e tutje se si do të veprohet përgjegjësia do të bie edhe mbi kryetarin aktual. Ai i sugjeroi kryetarit të komunës të marrë një vendim lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata ka skaduar dhe se ai objekt është duke u shfrytëzuar ilegalisht. Vendimi që duhet të merret duhet të jetë racional, dhe në konsultim me banorët lokal, këshillin e fshatit, me këshillin e arsimitarëve që punojnë aty në atë shkollë, këshillin e prindërve dhe akterët tjerë relevant. Është mirë të analizohet kjo çështje në aspektin shumëdimensional, se e ka ndonjë konsekuencë që dëmton procesin mësimor nga aspekti i sigurisë së nxënësve, ai mjedisor e të ngjashme, dhe nëse është e nevojshme le të formohet edhe komisioni kuvendar i propozuar më herët, ashtu që mos të sfidohet kuvendi e as kryetari i komunës, por të merret një vendim racional e i pranueshëm.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës** - tha se çështja e ngritjes së asaj fabrike në objektin e shkollës “Migjeni” në Stanoc të Epërm, është përcjellë me shumë kundërshti me petition pro dhe kundër, por e vërteta është se në atë kohë është aprovuar një rekomandim, ku komuna ka marrë obligime për ndërtimin e një çerdheje, një bibliotekë dhe fushë sportive, andaj tani komuna kur të planifikojë buxhetin për vitin 2023 mund të futë këto projekte për realizim. Pastaj shtoi se është mirë të ngritet komisioni për verifikimin e gjendjes në atë objekt dhe ceku se në bazë të raportit të mëhershëm atje figurojnë se janë të punësuar rreth 20 persona dhe janë investuar afër 150,000.00 € nga operatori ekonomik, ndaj tani është mëkat t’i hedhet poshtë kontributi atij investitori. Në fund tha se ato njësi kadastrale që nuk janë të lira të hiqen nga propozim-vendimi dhe të aprovohet si i tillë, ashtu që mos të bllokohet procesi i dhënies në shfrytëzim i pronës komunale.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** - tha se projekti i fabrikës në shkollën fillore “Migjeni” në Stanoc të Epërm, do të kundërshtohet fuqishëm nga banorët lokal, dhe nëse dëshirohet të mos mbyllen vendet e punës, atëherë ai investitor të vendoset në objektin e vjetër të shkollës në fshatin Pestovë. Mandej shtoi se nënkryetari i komunës është duke bërë një gabim të madh dhe po bën thirrje për shkelje ligjore, sepse ndërrimi i destinimit të pronës bie në kundërshtim me parimet ligjore.

**Albanez Tahiraj, drejtor i DGJKP-së** - sqaroi se pjesë e komisionit për verifikimin e gjendjes në objektin-shkollë në fshatin Stanoc i Epërm, ka qenë dhe kanë konstatuar se në atë fabrikë janë investuar rreth 170,000.00 € dhe janë të punësuar 16 persona, por ky numër mund të jetë edhe më i lartë për shkak se disa janë përfitues të asistencës sociale, dhe i kanë shmangur kontrata për të mos humbur të drejtën e asistencës sociale.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se kur është dhënë në shfrytëzim ky objekt është proklamuar që vitin e parë do të punësohen 60 punëtorë kryesisht gra, ndërsa nëse vazhdohet edhe më tej, ky numër të jetë 100 persona që do të punësohen. Andaj në këtë kontekst është shkelur kontrata. Ky objekt gjendet në oborrin e shkollës së re, në sipërfaqe prej 845 m<sup>2</sup> dhe i njëjti është dhënë pa pagesë dhe kjo i bie se nuk është arritur qëllimi i investimit. Tutje shtoi se nuk është e vërtetë që janë investuar 170,000.00 € në atë fabrikë, pasi që objekti i ri i shkollës ka kushtuar 300,000.00 € ndërsa në objektin e vjetër ka pasur shumë më pak intervenime. E vërteta është se numri i të punësuarave është shumë më i vogël se ai proklamuar nga ish-kryetari i komunës. Në fund shtoi se duhet të ulemi gjithë së bashku, ta gjejmë një zgjidhje, ashtu që ai objektet të jetë ashtu siç ka qenë objekt edukativo-arsimor, ndërsa investitorit t’i gjendet një zgjidhje tjetër.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës** - tha se nuk kemi nevojë të tensionohemi, dhe ta zgjatim debatin aq shumë, dhe përsëriti që me qëllim që të bëhet gjithçka transparente, të formohet një komision prej 5 anëtarëve, 2 nga ekzekutivi dhe 3 nga kuvendi, ashtu që të konstatohet gjendja faktike dhe kjo çështje prapë të vendoset nga ana e kuvendit. Tutje propozoi që pjesë e komisionit nga ekzekutivi të jetë Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e urbanizimit dhe Shqiponja Mikushnica, drejtoreshë e inspektimeve. Si zyrtarë komunal vlerësoi se të gjithë bartim përgjegjësi para qytetarëve, por edhe para bizneseve, andaj kërkoi nga anëtarët e kuvendit që kësaj çështjeje mos t'i qasen në mënyrë emocionale.

**Në vazhdim, kuvendi me 27 vota “për” vendosi që të themelojë një komision për konstatimin e gjendjes faktike në ish-objektin e shkollës “Migjeni”, tani fabrika e tekstit “Vitex” në fshatin Stanoc i Epërm, si dhe ky komision do të bëjë konstatimin e gjendjes faktike të një objekti që po ndërtohet në fshatin Pestovë:**

**Nga sa u tha më lart, u vendos:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni komunal ad-hoc kuvend-qeveri komunale për verifikimin e procesit të dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, verifikimin e dokumentacionit, investimet e bëra nga investitori, kontrata e punëtorëve lidhur me projektin, objekti i vjetër i shkollës “Migjeni” në fshatin Stanoc i Epërm që i është dhënë në shfrytëzim kompanisë së tekstit “Vitex” për zhvillimin e veprimtarisë biznesore. Po ashtu komisioni do të bëjë konstatimin e gjendjes faktike të një objekti që po ndërtohet në fshatin Pestovë, që konsiderohet se cenon moralin publik, sipas kundërshtimit të bërë përmes peticionit të banorëve të fshatrave Nedakoc dhe Pestovë, në përbërjen si në vijim:

**1.1 Mensur Kosumi, anëtar i kuvendit;**

**1.2 Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit;**

**1.3 Faton Hyseni, anëtar i kuvendit;**

**1.4 Fortuna Krasniqi drejtoreshë e Drejtorisë së Urbanizimit, dhe**

**1.5 Shqiponjë Mikushnica drejtoreshë e Drejtorisë së Inspektimeve.**

2. Obligohet Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi që bëjë verifikimin e proceseve të cekura si më lartë, të bëjë konstatimin e gjendjes faktike në objektet e cekura në dispozitiv të këtij vendimi, dhe pas përfundimit të këtij procesi, konform të gjeturave në terren, duhet të hartojë raport me shkrim dhe të njëjtin duhet të t'ia adresojë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vendosje meritorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Në vazhdim, kuvendi pas votimit me 29 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet lista e veçantë që planifikohet për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me

sipërfaqe prej 25832m<sup>2</sup>, P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m<sup>2</sup>, P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m<sup>2</sup>, ZK-Novolan, parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m<sup>2</sup>, ZK-Prelluzhë, parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m<sup>2</sup>, ZK-Strovc, parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 100543m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m<sup>2</sup>, ZK-Kollë, parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m<sup>2</sup>, ZK-Dumnicë e Llugës, parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m<sup>2</sup>, parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m<sup>2</sup>, ZK-Stanoc i Poshtëm, parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m<sup>2</sup>, ZK-Sllatinë, parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m<sup>2</sup>, ZK-Qytezë, parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 28502m<sup>2</sup>, ZK-Bukosh, parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m<sup>2</sup>, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m<sup>2</sup>, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m<sup>2</sup>, ZK-Liqen, pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-27, në sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m<sup>2</sup>, ZK Lummadh, ish-objekti i shkollës fillore në fshatin Stanoc i Epërm.

- 1.1** Parcela kadastrale P-70202044-00586-0 me sipërfaqe prej 25832m<sup>2</sup>, P-70202044-00529-0 me sipërfaqe prej 15761m<sup>2</sup>, P-70202044-01096-0 me sipërfaqe prej 2100m<sup>2</sup>, ZK Novolan, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.2** Parcela P-70202053-00366-1 me sipërfaqe prej 25436m<sup>2</sup>, ZK-Prelluzhë, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.3** Parcela P-70202063-00037-0 me sipërfaqe prej 54774m<sup>2</sup>, ZK-Strovc, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.4** Pjesë nga parcela P-70202037-00051-0 me sipërfaqe prej 45000m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 100543m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00337-0 me sipërfaqe prej 55449m<sup>2</sup>, parcela P-70202037-00699-0 me sipërfaqe prej 23272m<sup>2</sup>, ZK-Kollë, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.5** Parcela P-70202040-00431-0 me sipërfaqe prej 101525m<sup>2</sup>, ZK-Dumnicë e Llugës, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.6** Parcela P-70202028-00412-1 me sipërfaqe prej 35232m<sup>2</sup>, ZK-Stanoc i Poshtëm, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.7** Parcela P-70202028-00412-4 me sipërfaqe prej 6211m<sup>2</sup>, ZK-Stanoc i Poshtëm, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari afariste.

- 1.8** Parcela P-70202061-0079K-2 me sipërfaqe prej 14126m<sup>2</sup>, ZK-Sllatinë, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.9** Parcela P-70202062-0K106-1 me sipërfaqe prej 1002m<sup>2</sup>, ZK-Qytezë, jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari afariste.
- 1.10** Pjesë nga parcela P-70202010-00789-0 me sipërfaqe prej 20000m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 28502m<sup>2</sup>, ZK-Bukosh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.11** Parcela P-70202035-00474-0 me sipërfaqe prej 29693m<sup>2</sup>, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00482-0 me sipërfaqe prej 39838m<sup>2</sup>, ZK-Liqen, parcela P-70202035-00483-0 me sipërfaqe prej 13638m<sup>2</sup>, ZK-Liqen, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.
- 1.12** Pjesë e parcelës P-70202011-00435-27 me sipërfaqe prej 2000m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 69457m<sup>2</sup>, ZK-Lummadh, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari afariste.
- 1.13** Ish-objekti i shkollës fillore në fsh. Stanoc i Epërm, në sipërfaqe 845 m<sup>2</sup>, i cili gjendet në rrugën “Galip Maloku” nr.6, nën menaxhimin e Komunës së Vushtrrisë.
- 2.** Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit publik për pronat nga nënpika 1.1 deri 1.12. Për pronën në nënpikën 1.13 të zhvillohen procedurat e negocimit për dhënie në shfrytëzim. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duhet të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.
- 3.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi paraparak janë: certifikatat e pronës dhe kopjet e planit.
- 4.** Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
- 6.** Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë

**Refik Maloku, anëtarë i kuvendit** - tha se pjesa prej 13,000.00 hektarë, pyje të përshkruhen me vetëm një faqe informatë është më të vërtetë shqetësuese. Më tej shtoi se pyjet siç dihet janë mushkëritë e ambientit ku jetojmë, dhe procesi i fotosintezës shndërrohet në pyje, andaj kujdesi që ne po ju kushtojmë është minor. Kjo vërtetohet me faktin se Komuna e Vushtrrisë ka vetëm 6 roje pylli që është shifër e papërfillshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e suksesshme të pyjeve. Një qasje e tillë është tepër joserioze dhe tregon se në çfarë gjendje sot i kemi pyjet dhe ruajtjen e mjedisit.

**Ergin Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së** - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën në fjalë, duke dhënë përgjigje për anëtarët e kuvendit.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se gjendja e ruajtjes së pyjeve është alarmante, dhe pyeti drejtorin gjegjës se a ka mundësi të shtohet numri i rojtarëve të pyjeve, pasi që ky numër është tepër i vogël për t'i ruajtur me sukses pyjet. Tutje kërkoi nga kryesuesja e kuvendit që të mbajë rend në mbarëvajtjen e mbledhjes, pasi që nuk jemi serioz në diskutime dhe ka lëvizje të tepërta duke hy dhe dal jashtë sallës së kuvendit nga të pranishmit.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - tha se drejtorja gjegjëse duhet të hartojë një plan operativ për rajonizimin e pyjeve, sidomos aty ku janë të dendura, për të pasur qasje dhe ndërhyrje të zjarrfikësve në rastet e përhapjes së zjarreve në pyje, me qëllim të preventivës së përhapjes së zjarreve dhe mbrojtjes së tyre.

**7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë në përbërjen si në vijim:

- 1.1 Arlind Gogolli, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit (LDK);
- 1.3 Fatmire Cecelia anëtare e kuvendit (LVV);
- 1.4 Izet Miftari nga administrata komunale;
- 1.5 Egzon Haradinaj nga administrata komunale.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të takohet brenda afatit prej 7 ditëve, ku në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin.

3. Qëllimi i themelimit të këtij komisioni është emërtimi dhe caktimi i kufijve të lagjeve urbane në Komunën e Vushtrrisë.

4. Komisioni ka për detyrë që të paraqesë para Kuvendit të komunës, propozimet për emërtimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Komunës së Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

6. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8. Shqyrtimi i Peticionit të përbashkët i banorëve të sheshit “Adem Jashari” dhe rrugës “Galip Badivuku” për largimin e trafos së rrymës nga sheshi**

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - tha se kjo çështje e kësaj trafoje nuk është në kompetencat e komunës, por është në domenin e KEDS-it, dhe kjo paraqet një problematikë në vete për qytetarët

dhe komunën. Më tej ai vlerësoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet të analizojë që të gjejë një lokacion të përshtatshëm për vendosjen e kësaj trafoje, dhe këtë t’ia propozojë KEDS-it.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** - tha se shqyrtimi i peticioneve është obligim ligjor, ku adresohen shqetësimet e qytetarëve. Pastaj shtoi se nga mbledhja e KPF-së është kërkuar nga Drejtoria e Urbanizimit që të bëjë një analizë për gjetjen e një lokacioni për vendosjen e kësaj trafoje dhe i njëjti t’i sugjerohet KEDS-it. Ai pyeti se deri ku ka shkuar procesi i heqjes së kabllos nga sheshi i qytetit, për arsye se këto kablllo lidhen me trafon që sot është objekt shqyrtimi.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** - vlerësoi se është mirë që trafot që gjenden në qendër të qytetit dhe në sheshe të largohen në vende adekuate, ku mënjanohet rreziku për jetën e qytetarëve. Ai ceku se duhet të gjendet një modalitet ligjor mes komunës dhe KEDS-it, për zgjidhjen e kësaj problematike, duke respektuar konditat ligjore sepse KEDS, është kompani private dhe ne si kuvend nuk mund të marrim vendim për një gjë të tillë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - kërkoi nga qeveria komunale që të rishikojë procedurat nga qeverisja e kaluar, sepse ka indikacione që ka pasur një tender për të cilin janë paguar mjetet financiare nga komuna, dhe se në përshkrim të detyrave ka pasur obligim të kryhen, largimi i kabllove nëntokësore dhe largimi i trafos nga sheshi “Adem Jashari”. Lidhur me këtë çështje kërkoi raport me shkrim nga Drejtoria e Prokurimit se deri ku ka shkuar ky aktivitet i prokurimit, pse ka ngecur aktiviteti i largimit të atyre kabllove dhe se a është iniciuar ndonjë procedurë ligjore. Pastaj edhe pse KEDS është kompani private, komuna ka të drejtë të ndërmarrë veprime nëse kjo kompani rrezikon qytetarët, duke i dhënë një afat për largimin e atyre kabllove dhe mënjanimin e rrezikut.

**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit** - tha se komuna ka të drejtë t’i adresohet jo vetëm KEDS-it por edhe ZRRE, sepse ata janë autoriteti rregullues dhe licencues të kompanive të energjisë dhe ata mund ta detyrojnë KEDS-in, që në bazë të planit të operatorit të distribucionit të bëhet zhvendosja e asaj trafoje. Andaj propozoi që DSHP-ja menjëherë t’i drejtohet ZRRE-së, sepse komuna nuk ka kompetencë për largimin e trafove, por ka obligim t’i përgjigjet petitionit të qytetarëve.

**Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: **26 maj 2022**, konform obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka shqyrtuar petitionin e banorëve përgjatë sheshit “Adem Jashari” dhe Rr. “Galip Badivuku” të parashtruar në emër z. Faruk Saraçit, që lidhet me kërkesën e tyre për largimin e një trafoje të energjisë elektrike, e cila gjendet në lokacionin përballë postës së qytetit në sheshin “Adem Jashari”, andaj Kuvendi i komunës pas një analize të hollësishme, drejtorive të lartcekura iu parashtron këtë:

### **Kërkesë**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kërkon nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike, që në bashkëpunim me KEDS-in, ta shqyrtojë dhe analizojë me kujdes kërkesën që rrjedh nga peticioni i cekur më lart, konform legjislacionit në fuqi, si dhe duke marrë për bazë interesin qytetar, të marrë vendim për kërkesën që derivon nga peticioni, ashtu që në koordinim mes tyre të gjejnë një lokacion të ri të përshtatshëm për vendosjen e asaj trafoje.

Drejtoritë e cekura më lart obligohen të bëjnë konstatimin e gjendjes faktike dhe atë të rrezikshmërisë që paraqet stabilimenti në fjalë për banorët e atij lokaliteti, dhe konform të gjeturave në terren t'i propozojnë KEDS-it, dislokimin e asaj trafoje dhe vendosjen e saj në një lokalitet të përshtatshëm.

Obligohen drejtoritë e cekura më lart që të japin përgjigje me shkrim brenda afatit ligjor dhe për të njëjtën ta njoftojnë Kuvendin e komunës dhe parashtruesin e peticionit.

**9. Shqyrtimi i Peticionit të përbashkët të fshatrave Nedakoc dhe Pestovë për kundërshtimin e ndërtimit të një objekti që konsiderohet se cenon moralin publik**

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit** - konstatoi se i njëjti komision i cili është formuar për konstatimin e gjendjes faktike në objektin-shkollë në fshatin Stanoc i Epërm, fabrika <Vitex>, po ashtu i njëjti do të ketë mandat të vlerësojë dhe konstatojë gjendjen faktike të objektit në fshatin Pestovë, sipas peticionit të banorëve të atij lokaliteti që konsiderojnë se ai objekt cenon moralin publik.

**Kuvendi me vota “unanime” konstatoi se komisioni ad-hoc kuvend-qeveri komunale do të merret me konstatimin dhe verifikimin e gjendjes faktike në objektin në fshatin Pestovë që është objekt kundërshtimi me peticionin e banorëve.**

Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: **26 maj 2022**, konform obligimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatrave Nedakoc dhe Pestovë të parashtruar në emër **z. Avdullah Zhegrova**, që lidhet me kërkesën e tyre për kundërshtimin e ndërtimit të një objekti që konsiderohet se cenon moralin publik.

Andaj lidhur me këtë çështje ju njoftojmë se Kuvendi i Komunës së Vushtrisë ka themeluar një komision i cili do të merret me gjetjen e një zgjidhjeje lidhur me këtë problematikë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 16:10.**

**Bastri Duraku**

---

**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli-Latifi**



---

**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

<b>DATE/A:</b>	15.06.2020
<b>PËR/ZA/TO:</b>	KPF dhe Kuvendin Komunal
<b>PËRMES;</b>	Kryetari i Komunës Ferit Idrizi 
<b>NGA/OD/FROM;</b>	Abit Abiti, ZKF 
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Korniza Afatmësme e Buxhetore 2023-2025

Bazuar në Qarkoren Buxhetore 2023/01, e kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe po e dërgojmë për miratim në Kuvendin Komunal. Ky dokument është dokumenti bazë për planifikimin e Buxhetit Komunal, përmban prioritetet strategjike lidhur me caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve. Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025 është në përputhje me udhëzimet e dhëna me Qarkoren Buxhetore 2023/01 të nxjerra nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.


Shtojcë :

- Korniza Afatmesme e Buxhetore





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

---

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE**

**2023 - 2025**

**KOMUNA E VUSHTRRIË**

## **Përmbajtja**

- I. Hyrje
- II. Deklarata e prioriteteve afatmesme
- III. Vizioni i komunës
- IV. Misioni i komunës
- V. Korniza fiskale komunale
- VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2023-2025
- VII. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët
- VIII. Analiza gjinore
- IX. Informacionet sipas programeve


## I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB, të cilën po e paraqesim është një deklaratë e prioriteteve të politikave të qeverisë që ka për qëllim orientimin e ndarjes së mjeteve buxhetore gjatë procesit të ardhshëm buxhetor. Përkrah parashikueshmërisë në procesin e buxhetit, duke siguruar se buxheti bazohet në parashikimin afatmesëm, Korniza afatmesme buxhetore miratohet në parim çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Korniza afatmesme buxhetore, siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen e objektivave prioritare, të përcaktuara me Dokumentet strategjike dhe përditësimin e këtyre strategjive me procesin buxhetor 2023-2025

Hartimi i Kornizës afatmesme buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja buxhetore 2023/01 të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në pajtim me Nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Korniza afatmesme buxhetore i operacionalizon prioritetet e strategjisë. Buxheti për vitin 2023 dhe projeksionet për vitet 2024 dhe 2025 do të planifikohen në nivel të programeve dhe nënprogrameve, gjithashtu planifikimi i buxhetit duhet të bëhet edhe sipas kategorive ekonomike.

Janë pesë faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



KAB 2023-2025 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

## II. Deklarata e prioriteteve afatmesme

Bazuar në nevojat momentale të popullatës, resurset në dispozicion dhe përvoja, Komuna e Vushtrrisë është e pozicionuar për të gjeneruar një strategji të re zhvillimore që synon në përsosjen e strukturës së saj ekonomike, rritjen e punësimit, dhe krijimin e një ambienti për përshpejtimin e përgjithshëm të zhvillimit lokal, prodhimtarisë, bujqësi moderne dhe turizëm. Kjo strategji e re e zhvillimit ekonomik siguron një vizion për Komunën e cila përfshinë synimet specifike për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe ato të mesme (NVM) dhe të bujqësisë, si dhe programet dhe projektet për ti realizuar këto synime. Komuna e Vushtrrisë ka një shtrirje të bizneseve shumë të sukseshme dhe aktive në tregun e Kosovës dhe tregun e jashtëm që e ushtrojnë aktivitetin afarist aty. Në të vërtetë, Komuna e Vushtrrisë tanimë është duke punuar për të përsosur ambientin për biznes duke iniciuar formimin e Zonave Ekonomike si zona komerciale, artizanale dhe prodhuese.

Qytetarët e përfshirë, duke përfshirë këtu bizneset e mëdha dhe të vogla, ndërmarrësit dhe organizatat aktive në Komunë kanë sprovuar një ndryshim në mendimin rreth zhvillimit ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në këtë qasje të zhvillimit komunal. Këto synimet kërkojnë një riorganizim të konsiderueshëm, ndryshim në proceset e punës në institucionet e qeverisjes lokale, krijimin e mekanizmave të rinj për bashkëpunim ndërmes sektorit publik dhe privat, dhe formimi dhe ndërtimi i kapacitetit të institucioneve dhe organizatave të reja që do të marrin përgjegjësinë për zhvillim ekonomik.

Për të përmbushur këto synime ambicioze, Komuna e Vushtrrisë duhet të mobilizojë dhe angazhojë të gjitha resurset që janë në dispozicion, të cilat resurse qartazi do të jenë të pamjaftueshme për implementimin e tërë planit. Si rrjedhim, Komuna do të kërkojë përkrahje domethënëse nga nivelet tjera të qeverisjes në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare në formë të diturisë, përvojës, dhe ndihmës teknike dhe financiare për të transformuar vizionet dhe synimet e saja në realitet brenda periudhës më të shkurtër kohore të mundshme.

### Pozita gjeografike e Komunës së Vushtrrisë

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:

X1 : 200 50' 09'' dhe X2 : 210 07' 05'';

Y1 : 420 42' 20'' dhe Y2 : 420 55' 12''.

Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajin. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me sipërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km<sup>2</sup>. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka 69870 banorë të organizuar në 11866 ekonomi familjare.

### Gjendja aktuale në ekonomi

Bizneset aktive të Komunës së Vushtrrisë llogaritet të jenë 4 836. Në kohën e fundit vërehet një trend pozitiv në hapjen e bizneseve bujqësore të cilat hapin rrugë për biznese prodhuese. Prej këtyre bizneseve kryesisht dominon tregtia me shumicë, pastaj transporti, telekomunikacioni,

hotelet, restaurantet, industrinë përpunuese, më pas bujqësia dhe pylltaria, si dhe veprimtari të tjera ekonomike, në funksion të ngritjes së mirëqenies së vet qytetarëve. Edhe pse disa prej tyre nuk janë aktive, këto veprimtari ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Bazuar në të dhënat e Zyrës për regjistrim të bizneseve në komunë të cilat janë marrë në ARBK, nga bizneset të cilat operojnë në Komunën e Vushtrrisë, një pjesë e konsiderueshme e tyre merren me veprimtari tregtare 36.84% , në sektorin e shërbimeve (hotele dhe restorante) 9.66% , industri përpunuese 9.56 etj. Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje e lehtë në përqindjen e aktiviteteve në bujqësi, gjueti dhe pylltari, industri përpunuese dhe një rënie gjithashtu e lehtë në tregtinë me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisërisë

Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK

	Vushtrri
A - BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	294
B - MINIERAT DHE GURORËT (INDUSTRIA NXJERRËSE)	7
E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, AKTIVITETET E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE	21
F - NDËRTIMTARIA	401
H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI	534
I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	459
J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	122
K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT	16
L - AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË	16
M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	148
N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE	150
O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM	6
P - ARSIMI	55
Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE	94
R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI	66
S - AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE	273
G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	1,655

D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR	3
C - INDUSTRIA PËRPUNUESE	516
<b>Grand Total</b>	<b>4,836</b>

### **Burimet natyrore**

Komuna e Vushtrrisë është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i maleve të Çyqavicës është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar si dhe me relief karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojllojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastuduara sa duhet. Komuna e Vushtrrisë, përveç të tjerash, është e krahasuar edhe me shumë vende me potenciale të mineraleve dhe mundësive për eksploatime druri dhe guri, si:

- Duboc - magnezit e porcelan;
- Bivolak, Zhilivodë, Beçuk, Stroc, Gllavatin - thëngjill druri
- Pasomë, Tërllobuq, Smrekonicë dhe Shalë - eksploatimi i gurit
- Gumnishtë dhe Boshlan - pasuri të plumbit dhe zinkut
- Bajnskë - ujë termo-mineral
- Gjelbishtë dhe Gojbulë - ujë mineral
- Karaçë - burime minerale

### **III. Vizioni i komunës**

Komuna e Vushtrrisë është mjedis i përshtatshëm për ndërmarrësi dhe ka ndërtuar strukturë funksionale ndërlidhëse ndërmet sektorëve të bujqësisë, blegtorisë, edukimit dhe ndërmarrësisë. Vushtrria apo "Vicianum" është "shtëpi" e bizneseve dhe është identifikim i qendrës së dikurshme historike dhe tregate.

### **IV. Misioni i Komunës**

Si zonë e veçant historike do të marrë identitetin e saj të dikurshëm si qendër për bizneset prodhuese dhe aktivitetet tjera të biznesit duke rritë mirëqenjen ekonomike dhe sociale për të gjithë qytetarët e saj. Zhvillimi ekonomik lokal do të arrihet si bashkëveprim i zhvillimit të ambientit biznesor, prodhimtarisë dhe kulturave bujqësore, me sistem arsimor të harmonizuar me ekonominë lokale duke siguruar standard të mirëqenë jetsor dhesocial. Administrata komunale do të jetë në shërbim të plotë të qytetarve dhe bashkëpunëtor i akterëve të ekonomisë lokale.

Bazuar në dokumentet strategjike, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2023-2025 të Qeverisë së Kosovës dhe prioritetëve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2023/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tri vitet e ardhshme. Synimi i Komunës së Vushtrrisë është që të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit, jetës sportive dhe synon një kualitet më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

## ***SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE***

Si rezultat i hulumtimit dhe analizimit të saj, Komuna ka identifikuar aftësitë për të krijuar ndërmarrjet si një forcë që mund të jetë çelës për të krijuar ndërmarrje të reja, zhvilloj ato ekzistuese, dhe të inkurajoj krijimin e vendeve të punës. Gjatë zhvillimit të aftësive për të krijuar ndërmarrjet, Vushtrria duhet gradualisht ta ringjallë administratën komunale në shërbim të bizneseve, e cila do të kontribuojnë për një kualitet më të mirë të jetës për qytetarët e saj. Komuna do të përpiqet të zhvilloj sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe të kulturës me qëllim që të transformojë Komunën e Vushtrrisë në një qendër dinamike të ndërmarrjeve. Gjatë procesit të punëtorisë (intervistave), janë anë shqyrtuar ide të programeve për arritjen e këtyre synimeve strategjike. Idetë e propozuara ishin vlerësuar si dhe janë prezantuar këto konkluzione. Vazhdimi i procesit kërkon analizim më të thellë për të siguruar se projekt propozime kualitative do të rezantohen te akterët lokal dhe tek komuniteti i donatorëve. Objektivat për secilin synim strategjik gjithashtu janë prezantuar. Këto qëllime janë konturuar nga nën-grupet dhe pastaj janë vlerësuar. Si rezultat, Komuna ishte në gjendje të identifikojë tri projektet me prioritet të lartë për secilën synim të saj.

**SYNIMI STRATEGJIK 1- Klimë biznese të përshtatshme për biznese ekzistuese dhe tërheqjen e investimeve të jashtme në me fokus në prodhim**

1. Përkrahja e prodhuesve
2. Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmeve të organizimit të biznesit
3. Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës
4. Rregulloret komunale për stimulimin e biznesit dhe krijimi i fondeve për përkrahjen e bizneseve

**SYNIMI STRATEGJIK 2- Bujqësi moderne me produkte kualitative industriale dhe të konsumit direkt për tregun lokal,**

1. Krijimi i Oazave Bujqësore (koperativave bashkëkohore)
2. Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore
3. Mundësimi i aplikimit të teknikave dhe teknologjive moderne bujqësore
4. Sigurojë përgatitje profesionale dhe stimulim të bujqësisë

**SYNIMI STRATEGJIK 3 - Ngritja e kualitetit të jetës kulturore dhe zhvillimit të turizmit**

1. Vushtrria qendër historike
2. Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe sportiv

### **Aktivizimi i zonës aktuale**

Komuna e Vushtrrisë është në ndërtim e sipër të zonës industriale me sipërfaqë rreth 14 ha. Përderisa kjo zonë në proces Komuna e Vushtrrisë, specifikisht Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe bujqësi mund të filloj me ndërtimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin e zonës dhe tërheqjen e investitorëve. Duke u bazuar në studimin e fizibilitetit të zonës, fillimisht mund të targetohen bizneset që do të alokohen në zonë. Është shumë e rëndësishme që bizneset ekzistuese të konsultohen fillimisht për nevojat dhe kapacitetet e tyre për vendosjen në zone industriale duke pas parasysh që ato janë bartëse të nivelit të deritashëm i zhvillimit ekonomik lokal.

### **Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve**

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.

### **Përmirësimi i ambientit të komunës dhe qëndrueshmëria e tij**

- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi), transporti dhe kanalizimi;
- Përmirësimi i standardeve ambientale;
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara.

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

### **Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve**

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes fushave prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2023-2025 do të shoqërohen me shumica të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike, të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

### **Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit 2023 - 2025**

Procesi buxhetor për vitet 2023-2025 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore të qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Gjatë hartimit të këtij dokumenti duhet t'i japim prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e objektivave të përcaktuara me dokumentet strategjike.
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake;
- Të përfshijmë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të projekteve me bashkëfinancim të jashtëm;
- Të kujdesemi që të hyjmë në obligim për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza buxhetore;

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:



- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nënprogrameve në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2023 dhe projeksionet për vitet 2024 – 2025;

Planifikimi i projekteve në pajtim me UA MF NR.04/209 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe shpenzimet e shpronësimit. Organizatat buxhetore, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.

Planifikimi i projekteve në pajtim me Udhëzim Administrativ Mf- Nr. 06/2019 Për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projekteve Kapitale. Kriteret e përzgjedhjes sipas këtij UA janë:

1.1.Përputhja me Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 si dhe me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal.

### **Parimet themelore**

Realizimi i prioriteteve qeveritare do të çojë drejt zbatimit të politikave të përcaktuara sektoriale, të cilat duhet të respektojnë kufijtë e shpenzimeve.

Procesi i përgatitjes së parashikimit të shpenzimeve (kufijve buxhetorë) për periudhën 2023-2025, është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësim të mjedisit brenda të cilit zhvillohen aktivitetet e shtuara të sektorit privat, nxitje të punësimit të qëndrueshëm si dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. E gjithë kjo do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Përputhje me politikat prioritare të Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2023-2024, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe Programin e Qeverisë 2021-2025.
- Alokimin e shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave të politikave të Qeverisë;
- Rritje të cilësisë dhe besueshmërisë në procesin buxhetor si dhe ndërlidhje më të mirë ndërmjet politikave dhe buxhetit.
- Ekzekutim më të lartë të shpenzimeve në krahasim me planifikimin e tyre, me theks të veçantë në shpenzimet kapitale, duke realizuar synimet specifike prioritare.
- Ndërlidhjen me financimin e jashtëm të ofruar nëpërmjet IPA dhe kanaleve të tjera.

### **Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)**

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2023. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Komunitat duhet të marrin parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit komunal për periudhën 2023-2025. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Forma e ofrimit të këtyre informatave është dhënë në Aneksin I. Gjithashtu, me rastin e propozimit të buxhetit, organizata buxhetore duhet të adresojë në mënyrë korrekte vërejtjet dhe propozimet e zyrtarit përgjegjës për barazi gjinore të organizatës buxhetore.

## V.Korniza fiskale

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin vijues 2023. Qëllimi kryesor i përcaktimit të prioriteteve është që të bëhet ndërlidhja, duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të mjedisit makroekonomik në vend dhe planifikimeve buxhetore për vitet vijuese, për një perspektivë trevjeçare në përputhje me objektivat strategjike të Qeverisë.

- Propozon krijimin e zonave të tokës së ndërtimit dhe përpunon lokacionet për dhënien e tokës në shfrytëzim;
- Zbaton programet e sektorëve të tjerë të Administratës komunale, në fushën e ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve kapitale, si dhe vendimet komunale nga përgjegjësia e kësaj drejtorie;
- Përgatit propozimet e Rregulloreve dhe akteve tjera nga lëmi i ndërtimit, planifikimit, projektimit dhe rregullimit hapësinor;
- Udhëzon dhe orienton subjektet nga fusha e ndërtimit, bashkëpunon me subjektet udhëheqëse dhe personat juridikë nga fusha e ndërtimit, ofron të dhënat dhe informata të tjera bazike profesionale të nevojshme për punën e udhëheqjes komunale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimit;
- Kryen detyra të tjera të deleguara nga ligji dhe rregulloret tjera në fuqi;
- Harton projektprogramin për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Propozon dhe zbaton programin e veçantë për rregullimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Organizon dhe trajnon grupet profesionale dhe kapacitetet njerëzore për procedurën e legalizimit.
- Organizon dhe cakton grupin profesional për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;
- Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe manualin për legalizim;
- Shqyrton programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në tërësi të hapësinore ilegale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

Indikatori	2019	2020	2021
Koha për lëshimin e lejes ndërtimore	30-45	30-45	30-45
% e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjor	70	80	85

### **Bujqësi, pylltari dhe zhvillimi rural**

**Misioni:** Për të krijuar ambient tërheqës, bashkësi familjare ekonomikisht të qëndrueshme në zonat rurale, duke përfshirë të gjitha grupet pa dallim etniteti, feje apo gjinie për një ambient të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe duke promovuar praktikën e mira bujqësore.

**Vizioni:** Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe ta bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore përmes mbajtjes së një shënimi/të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët dhe për të stimuluar dhe promovuar blerjet blegtorale dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu bashkëpunojmë ngusht me ekspertë të IADK që të ofrojmë këshilla për fermerë për të zhvilluar kapacitetet prodhuese, ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg, duke promovuar praktikën më të mira bujqësore. Ne do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

Indikatori	2019	2020	2021
% e tokës bujqësore që është duke u kultivuar	caku për vitin 2020	caku për vitin 2021	caku për vitin 2022
5986 ha	6083 ha	6154 ha	6250 ha

### **Arsimi dhe Shkenca**

**Misioni:** Çdo personi do duhet t'i mundësohet arsimit, sporti dhe kultura nëpërmjet përvojave të të nxënies pozitive dhe do të stimulohet për arritjet e tij / saj të plota, veprime të cilat do ju japin atyre besim dhe do të gjejnë vet përmbushje me atë që merren.

**Vizioni:** Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të mëtejshëm për të rriturit dhe për ta bërë këtë kemi siguruar

zbatimin e rregullores kombëtare, legjislacionin e duhur arsimor dhe politikat gjegjëse si rezultat. Po ashtu marrim pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar se profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë, të rinjtë dhe të moshuarit dhe njëherit i mbajmë të gjitha shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikave për të matur nivelin e cilësisë së arsimit që ofrohet nga komuna. Gjithashtu komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe të procesit përbrenda komunës, si dhe bëjmë promovimin e sportit dhe kulturës me organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore, përkrahjen e organizatave sportive dhe drejtimin e qendrës komunale të kulturës.

Indikatori	2019	2020	2021
% e fëmijëve që arrijnë moshën për të filluar shkollën	8 %	7.93 %	7.91%
% e nxënësve që kalojnë provimin shtetëror	53.95 %	54.33%	55.05%
% e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime	100 %	100 %	100 %
Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm.	Niveli 0, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli 0, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli 0, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17

## Administrata dhe Personelit

Administrata dhe Personeli

Misioni: Misioni i administratës Komunale është që përmes shërbimeve sa më kualitative, maksimalisht dhe në mënyrë sa më efektive t'i plotësojmë nevojat që presin qytetarët e

Vushtrrisë dhe të gjithë atyre të cilët i janë drejtuar komunës së Vushtrrisë, para se gjithash t'i plotësojmë të gjitha kërkesat ligjore dhe të tjera të të gjitha palëve të interesuara.

**Vizioni:** Ne përpiqemi të jemi një Komunë dinamike që përcakton trendet, duke ofruar shërbime cilësore të përgjegjshme ndaj kërkesave dhe sfidave të komunitetit dhe mandatit tonë kushtetues, në të cilin të gjithë palët e interesuara mund të marrin pjesë në harmoni dhe dinjitet.

Përmes shërbimeve që i ofrojmë si Drejtori dhe shërbimeve të tjera të cilat pretendojmë t'i vëmë në funksion, përpiqemi t'ua bëjmë sa më të lehtë qasjen në shërbimet tona qytetarëve, si dhe funksionimin sa më efektiv dhe eficient nga ana jonë.

Vizioni ynë si drejtori është që me punën dhe profesionalizmin tonë t'ua lehtësojmë marrjen e shërbimeve qytetareve, si dhe të jemi transparent e llogaridhënës në punën tonë.

Indikatori	2020	2021	2022
Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile	60,000	60,000	60,000
Numri i kërkesave të pranuar nga QSHQ	70,000	70,000	70,000

## **Buxheti dhe financat**

**Misioni:** Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e fondeve komunale.

**Vizioni:** Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët e Vushtrrisë. Ne mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloreve tjera përkatëse. Ky veprim përfshin zbatimin e rregulloreve mbi tarifën dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu do i përgatitim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutorë komunale.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>DATE:</b>	<b>08.06.2022</b>
<b>PËR:</b>	<b>Kuvendin e Komunës</b>
<b>PROPOZUES:</b>	<b>Ferit Idrizi</b> <b>Kryetar i Komunës së Vushtrrisë</b>
<b>HARTUES:</b>	<b>Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural</b> <b>Drejtori i Drejtorisë: z. Ergin Sunguri</b>
<b>TEMA:</b>	<b>Akt – përcjellës</b>

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur draft –rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat, raportin nga konsultimet publike me qytetarë bashkë me listën e pjesëmarrësve dhe procesverbalin nga takimi i komisionit për hartimin e draft rregullores.

Gjate kësaj kohe komisioni ka evidentuar mangësitë në këtë rregullore ku si pasoje e këtyre mangësive ka qenë e kufizuar përkrahja ndaj fermerëve dhe njëkohësisht ka hartuar draft-rregulloren për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat. Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ(MAPL) nr.06/2018 për standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna ka mbajtur takimi me qytetar me datë 16.05.2022, ku raportin nga ky konsultim e gjeni te bashkëngjitur në shtojcë të këtij akt përcjellësi. Po ashtu ju informojmë se për një muaj qytetarët kanë pasur mundësi të dërgojnë komentet, vërejtjet, kërkesat dhe sugjerimet rreth draft –rregullores në adresën zyrtare elektronike, mirëpo se nuk kemi pasur asnjë koment vërejtje, sugjerim apo kërkesë lidhur me këtë çështje,.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI



**Për,** KPF dhe Kuvendin e Komunës  
**Propozues,** Kryetari i Komunës  
**Hartues,** Drejtoria për EBPZHRë  
**Tema,** Draft-Rregullore

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12, shkronja “c” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008”; neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27 e datës 3 qershor 2018”, neni 36, paragrafi 3 i rregullores financiare Nr.01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike, neni 43, pika 4 dhe 6, Rregulloren e MF Nr.-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik, si dhe nenin 40, paragrafi 2, pika “a” të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2022 miraton këtë:

**DRAFT - RREGULLORE  
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORES (KKV) NR.03/2020 PËR  
PËRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT**

**Neni 1**

Me këtë Draft-rregullore, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja (KKV) nr.03/20 datë 27/02/2020, për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

**Neni 2**

Pika 1.1 e nenit 2 riformulohet si në vijim:

**Subvencionet dhe grantet-** përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në formën e pajisjeve dhe makinave, serra, material fidanor për pemë e perime, bagëti, shpezë, bletë, farëra të llojeve të ndryshme e repromaterial tjetër për individë dhe biznese, si dhe përkrahje me mjete financiare.

**Neni 3**

Pika 4 e nenit 5 hiqet.

#### **Neni 4**

Pika 2 e nenit 6 riformulohet si në vijim:

Personi fizik dhe juridik brenda vitit mund të jetë përfitues i më shumë se një lloji të grantit apo subvencionit nëse i plotëson kushtet specifike të thirrjes.

#### **Neni 5**

Pika 4 e nenit 8 riformulohet si në vijim:

Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 3 anëtarëve.

#### **Neni 6**

Pika 3 e nenit 9 riformulohet si në vijim:

Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.

#### **Neni 7**

Pika 1 e nenit 11 riformulohet si në vijim:

Brenda shtatë (7) ditë pune nga data e mbylljes së thirrjes publike, komisioni vlerësues bënë hapjen e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale, duke përfshirë kriteret e paraqitura në këtë rregullore.

#### **Neni 8**

Pika 1 e nenit 12 riformulohet si në vijim:

Komisioni pas vlerësimit të aplikacioneve në aspektin procedural vazhdon menjëherë me shqyrtimin e aplikacioneve dhe atë jo më gjatë se katërmëdhjetë (14) ditë pune, nga dita e përfundimit të afatit të aplikimit në shpalljen publike.

#### **Neni 9**

Pika 6 e nenit 12 hiqet.

#### **Neni 10**

Pika 2 e nenit 13 riformulohet si në vijim:

Në afat prej 5 ditëve të punës palët e pakënaqura me shkrim i drejtohen komisionit të ankesave për ndarjen e subvencioneve.



#### **Neni 11**

Pika 4 e nenit 13 riformulohet si në vijim:

Në këtë fazë komisioni i ankesave kërkon nga komisioni i vlerësimit të aplikacioneve listën e aplikuesve së bashku me dokumentacionin e tyre.

#### **Neni 12**

Neni 16 hiqet.

#### **Neni 13**

Pikat tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

#### **Neni 13**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje (të ndryshuar dhe plotësuar) obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

#### **Neni 14**

Kjo rregullore e ndryshuar dhe plotësuar hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli Latifi

-----  
Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNË E VUSHTRRËS - QESHINA VÛÇITRË	
DI Nr. / Be	46/20
Nr. I fq. / Nr. e	- 12 -
Dash. / Datim	27.02.2020
VUSHTRRË - VÛÇITRË	



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

---

**RREGULLORE  
(KKV) NR.03/2020 PËR PËRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI  
DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT**

**Shkurt, 2020**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "c" të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës. 4, qershor 2008"; neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 27 e datës. 3 qershor 2018"; neni 36, paragrafi 3 i Rregullores Financiare Nr. 01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike; neni 43, pika 4 dhe 6; Rregulloren e MF, Nr-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik, si dhe neni 40, paragrafi 2, pika "a" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 shkurt 2020 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHMË**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoritë e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore, për personat fizikë dhe juridikë.
2. Bazuar në fondin e ndarë buxhetor për vitin aktual, DEBPZHR bën planin vjetor sipas kërkesave të arsyetuara të palëve, ndanë mjete financiare buxhetore- për realizimin e projekteve të planifikuara sipas procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.
3. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga organet komunale gjatë përzgjedhjes së përfituesit.

#### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Përveç përkufizimeve të përcaktuara me ligjet tjera përkatëse, përkufizimet e cekura më poshtë e kanë këtë kuptim:
  - 1.1 **Subvencionet dhe grantet** - përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në formën e pajisjeve dhe makinave, serra, material fidanor për pemë e perime, bagëti, bletë, farëra të llojeve të ndryshme e repromaterial tjetër për individë dhe biznese.
  - 1.2 **Përfituesit**- nënkupton personat fizikë dhe juridikë që përfitojnë të mira materiale nga kategoria e subvencioneve apo granteve të planifikuara në buxhetin e komunës.

- 1.3 **Banor rezident** - nënkupton personin që jeton në Komunën e Vushtrrisë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.
- 1.4 **Komision** - nënkupton komisionin e emëruar nga Kryetari i komunës, në koordinim me drejtorin e drejtorisë, për vlerësimin e aplikacioneve të parashtruara për makina dhe pajisje të ndryshme apo grante.

### **Neni 3** **Limitet buxhetore**

1. Komuna ndanë subvencione dhe grante, duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal për të cilin ndahen subvencionet dhe grantet.
2. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve dhe granteve për fermerë dhe biznese, mbi bazën e kërkesës së tyre dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

### **Neni 4**

#### **Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione dhe grante**

1. Personi fizik dhe juridik mund të jetë përfitues i subvencioneve dhe granteve të ndara nga komuna, nëse i ka të përfunduara obligimet ndaj komunës.
2. Aplikacioni dhe projekt-propozimi duhet të jenë të qarta, të arsyetuara dhe objektivisht të realizueshme.
3. Kushtëzimi me përfundimin e obligimeve ndaj institucioneve tjera të personit fizik dhe juridik, mund të përcaktohet sipas fushave specifike nga vetë komuna dhe të përcaktuara më tutje me këtë rregullore.

### **Neni 5**

#### **Procedura e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve dhe granteve, si dhe përkrahja e bizneseve në sektorin privat**

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve dhe granteve nga Komuna e Vushtrrisë mund të zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike.
2. Gjatë përkrahjes përmes thirrjes publike të komunës përcaktohen qartë fusha e përkrahjes, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informatat tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas procedurave të parapara me nenin 12 të kësaj rregulloreje.
4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave brenda thirrjes publike të komunës bëhet brenda pesë deri pesëmbëdhjetë (5 - 15) ditë pune nga dita e mbylljes së aplikimit.

## Neni 6

### Përfshirjet nga përkrahja

1. Personat jorezidentë në Komunën e Vushtrrisë nuk mund të jenë përfitues nga Komuna e Vushtrrisë.
2. Personi fizik dhe juridik brenda vitit mund të jetë vetëm njëherë përfitues i grantit, përjashtimisht vetëm në raste kur nuk ka aplikues tjerë.
3. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në kontratën apo në marrëveshjen në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe përfituesit, për 3 (tri) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e përfitimeve.

## Neni 7

### Shpallja publike për ndarjen e subvencioneve dhe granteve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve dhe granteve fillon përmes shpalljeve publike, të cilat publikohen në ueb-faqen e komunës, mediat lokale, si dhe në çdo mjet dhe vend tjetër të përshatshëm.
  - 1.1. Në shpallje përcaktohen saktë kriteret dhe procedurat për të aplikuar për ndarjen e subvencioneve dhe granteve, të cilat përcaktohen sipas kësaj rregulloreje.
  - 1.2. Shpallja publike qëndron e publikuar së paku 15 ditë pune nga data e shpalljes.
  - 1.3. Afati i një shpalljeje publike fillon që nga momenti kur publikohet në ueb-faqen e komunës dhe në tabelën e shpalljeve.

## Neni 8

### Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike

1. Kryetari i komunës në koordinim me drejtorin e drejtorisë, emëron komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve, kurse në përbërje të këtij komisioni duhet të ketë profesionistë që janë njohës të mirë të fushave specifike.
2. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve vepron në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë dhe bazuar në thirrjen publike.
3. Kryesuesi i komisionit dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave duhet të jenë shërbyes civilë, ndërsa njëri nga ta duhet të jetë nga sfera profesionale.
4. Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 3-5 anëtarë.

5. Përbërja e komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
6. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e aplikacioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kriterëve të paracaktuara.

#### **Neni 9**

##### **Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve**

1. Kryetari i komunës emëron komisione me mandat dyvjeçar (2) për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve në përbërje të përfaqësuesve nga fusha specifike. Anëtarët e komisionit do të shërbejnë për një mandat.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve dhe granteve duhet të jenë shërbyes civilë.
3. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3-5 anëtarëve.
4. Komisioni mbanë procesverbalin nga mbledhjet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

#### **Neni 10**

##### **Parandalimi i konfliktit të interesit**

1. Në fillim të përzgjedhjes së përfituesve, komisioni duhet të sigurojë që të mos ekzistojë konflikt i interesit i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
2. Komuna si mbështetëse financiare duhet të sigurojë shmangien e çfarëdo konflikti të interesit në rastin e marrjes së vendimit për aplikacionet.
3. Anëtarët e komisionit vlerësues, përkatësisht të komisionit të ankesave, duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komisione është në përputhje me legjislacionin në fuqi, për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt i interesit.
4. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet të kërkojnë nga udhëheqësi zëvendësimin e tyre.
5. Anëtari rezervë i komisionit zëvendëson anëtarin i cili tërhiqet, për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesit.

## Neni 11

### Vlerësimi i aplikacioneve në aspektin procedural

1. Brenda pesë deri pesëmbëdhjetë (5- 15) ditëve nga data e mbylljes së thirrjes publike, komisioni vlerësues bënë hapjen e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale. duke përfshirë kriteret e paraqitura në këtë rregullore.
2. Në këtë fazë komisioni vlerësues ka të drejtë të kërkojë sqarime shtesë nga aplikuesit.

## Neni 12

### Vlerësimi i aplikacioneve dhe vendimmarrja

1. Komisioni pas vlerësimit të aplikacioneve në aspektin procedural vazhdon me shqyrtimin e aplikacioneve dhe atë jo më gjatë se pesë deri pesëmbëdhjetë (5 - 15) ditë pune, nga dita e përfundimit të afatit të aplikimit në shpalljen publike, varësisht prej projektit.
2. Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave veprojnë në pajtim me legjislacionin për financat publike dhe dispozitat e kësaj rregulloreje, si dhe legjislacionin në fuqi.
3. Rekomandimet e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve dhe granteve merren me shumicë të votave, nga numri i përgjithshëm i komisionit.
4. Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij, i cili duhet të nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit
5. Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret për subvencione dhe grante, do të refuzohen nga komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve.
6. Komisioni para bërjes publike të listës me përfitues të grantit, listën e dërgon te drejtori i drejtorisë.
7. Komuna i njofton në mënyrë publike. në tabelën e shpalljeve për përfshirje ose jo në listën e përfituesve të subvencioneve apo të granteve dhe njofton për të drejtën dhe procedurën e parashtrimit të ankesës.

## Neni 13

### Përfundimi i vlerësimit dhe publikimi i rezultateve

1. Pas përfundimit të vlerësimeve, rezultatet e vlerësimit publikohen në ueb-faqen e komunës dhe në tabelën e shpalljes publike.
2. Në afat kohor prej 7 ditëve palët e pakënaqura me shkrim i drejtohen komisionit vlerësues të ankesave.

3. Komisioni vlerësues i ankesave në afat prej 5 ditëve bënë shqyrtimin e ankesave dhe jepin konstatimin e tyre.

4. Në këtë fazë, komisioni vlerësues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve dhe listën e aplikuesve me dokumentacionin e tyre:

5. Në rast të dështimit të ndonjërit nga aplikuesit e listës preliminare të përfituesve për të përmbushur kërkesat e paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, do të merren në konsideratë aplikacionet që kanë mbetur jashtë listës paraprake dhe që kanë më së shumti pikë.

6. Rezultatet paraprake shndërrohen në rezultate përfundimtare, nëse brenda afatit të paraparë për ankesa nuk paraqitet ndonjë ankesë.

7. Nëse është paraqitur ndonjë ankesë, rezultatet paraprake shndërrohen në rezultate përfundimtare pasi të jenë trajtuar ankesat e aplikuesve.

#### **Neni 14** **Ruajtja e dokumentacionit**

1. Drejtoria komunale e fushës përkatëse, në të cilën ndahen subvencione apo grante, përgatitin raporte, duke ofruar dokumentacion përkatës, ku përfshihen:

- 1.1. Lista e aplikuesve dhe dokumentet përcjellëse, sipas kriterëve të paraqitura në shpallje.
- 1.2. Dokumentet e komisionit përzgjedhës dhe kriteret e vlerësimit.
- 1.3. Lista e aplikuesve për subvencione apo grante.
- 1.4. Lista e përfituesve me pikët e fituara.
- 1.5. Çdo dokument tjetër relevant që ka të bëjë me shpalljen e projektit për ndarje të subvencioneve apo granteve.
- 1.6. Raportet dhe dokumentet tjera relevante protokollohen dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e komunës.

#### **Neni 15**

##### **Marrëveshja në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe përfituesve të subvencioneve dhe granteve**

1. Për realizimin e përkrahjes duhet të lidhet një marrëveshje në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe përfituesit, me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes Komunës së Vushtrrisë apo drejtorisë kompetente dhe përfituesit të subvencionit apo grantit, qëllimin, formën e përkrahjes, shumën e mjeteve, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, raportimin, hyrjen në fuqi, si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen.



2.Kjo marrëveshje, përfituesve do t'u ofrohet për nënshkrim para se ata ta bëjnë pagesën e participimit.

## Neni 16

### Ekzekutimi i vendimit

1. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, drejtori i drejtorisë në bashkëpunim me Kryetarin e komunës marrin vendim për ndarjen e subvencioneve dhe granteve. Ky vendim bëhet i ekzekutueshëm nëse:

- 1.1.Nuk është paraqitur ankesë sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje;
- 1.2.Me vendimin e komisionit të ankesave refuzohet ankesa;
- 1.3.Komisioni i ka shqyrtuar ankesat dhe ka dhënë konstatimin përfundimtar.

## Neni 17

### Monitorimi i përfituesve në lëmin e caktuar

1. Për kontrata të së njëjtës natyrë, komuna apo drejtoria përkatëse cakton një zyrtar përgjegjës, i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Komuna mund të formojë edhe ekip për këtë qëllim.

2. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e përdorimit të mjeteve të ndara nga komuna.

3. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes të mjeteve të ndara.

4. Monitorimi sipas paragrafit 1 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite, nga data e përfitimit në lëmin e caktuar.

5. Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës nga përfituesit, zyrtari/ekipi monitorues raporton në drejtorinë përgjegjëse komunale, duke rekomanduar për hapat e mëtejshme. Masat e propozuara duhet të jenë procedurale me shkeljen e bërë nga përfituesi.

6. Në rastet e shkeljeve të rënda të kontratës. Kryetari i komunës mund të nxjerrë vendim për anulimin e kontratës dhe masa për iniciimin e procedurave gjyqësore përkatëse.

## Neni 18

### Kriteret për raste urgjente

1. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i mundshëm i granteve për rastet urgjente, të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore janë si në vijim:

1.1. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme natyrore (zjarrfikësit, Shërbimi Policor i Kosovës, komisioni i veçantë i komunës).

1.2. Dëshmia se merret me veprimtarinë e caktuar bujqësore apo biznes të definuar si lëmi.

1.3. Gjendja e rëndë ekonomike -- familjare e konstatuar nga komisioni i veçantë.

## Neni 19

### Përkrahja dhe grantet për zhvillim ekonomik

1. Komuna mund të përkrahë me grante për zhvillim ekonomik duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

1.1. Zejet tradicionale;

1.2. Aksesorë;

1.3. Agrobizneset;

1.4. Teknologji informative;

1.5. Bizneset inovative;

1.6. Aktivitetet e shoqatave, të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin;

1.7. Inkubatorët e biznesit;

1.8. "Start-up" bizneset;

1.9. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve njerëzore për zhvillimin e biznesit;

1.10. Përfitues të granteve për zhvillim ekonomik mund të jenë vetëm bizneset që veprojnë në Komunë të Vushtrrisë.

1.11. Përfitues të granteve për zhvillim ekonomik nuk mund të jenë bizneset që kanë obligime financiare të papaguara komunale dhe ATK-së.

## Neni 20

### Përparësitë gjatë ndarjes të subvencioneve dhe granteve për zhvillim ekonomik

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve apo granteve për zhvillim ekonomik, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi specifike, si në vijim:

1.1. Bizneseve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që gjenerojnë punësim;

1.2. Femrave, të rinjve, zonave rurale, personave me nevoja të veçanta, kategorive të veçanta dhe komuniteteve;

- 1.3. Bizneset që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta 50% të vlerës;
- 1.4. Bizneset që posedojnë dëshmi apo certifikime profesionale;
- 1.5. OJQ-të, të cilat aplikojnë me projekte biznesi dhe të cilat mundësojnë gjenerim të vendeve të punës;
- 1.6. Bizneseve apo fermerëve që nuk kanë përfituar në tri vitet e fundit nga komuna, nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër.

#### **Neni 21**

##### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për persona fizik**

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve dhe granteve, e të cilat ndikojnë në zhvillim ekonomik duhet të jenë (duke mos u kufizuar):
  - 1.1. Projekti ideor i aplikuesit (i marrë në drejtorinë gjegjëse);
  - 1.2. Dokumenti identifikues;
  - 1.3. Certifikata e vendbanimit (për persona fizikë);
  - 1.4. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
  - 1.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
  - 1.6. Dëshmi për bashkëfinancim (nëse ka bashkëfinancim);
  - 1.7. Dëshmi për pronëri e paluajtshme.

#### **Neni 22**

##### **Përkrahja e fermerëve në bujqësi**

1. Komuna me vendim të Kuvendit komunal mund të ndajë subvencione dhe grante për bujqësi, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
  - 1.1. Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativave bujqësore, në fushat bujqësore me prioritet për komunën;
  - 1.2. Organizimin e panairove, seminareve, vizitave studentore;
  - 1.3. Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim;
  - 1.4. Projekteve në sektorin e pylltarisë;
  - 1.5. Ndarjen e pajisjeve dhe mekanizmit bujqësor;
  - 1.6. Ngritjen e serrave;
  - 1.7. Projekteve në fushën e pemëtarisë dhe perimtarisë;
  - 1.8. Projekteve në fushën e bletarisë;
  - 1.9. Projekte në fushën e blegtorisë;
  - 1.10 Projekte në fushën e lavërtarisë.

2. Komuna publikon secilën thirrje për aplikim në ueb-faqen zyrtare të saj dhe në tabelën e shpalljeve, dhe për secilën fushë të përkrahjes apo grantit bujqësor, komuna duhet të nxjerrë formularët e veçantë të aplikimit.

3. Komuna përmes drejtorisë përkatëse, çdo fillimvit duhet të organizojë takime publike me palët e interesuara për të shpjeguar detajet e thirrjeve publike për atë vit dhe përmes këtyre takimeve shpjegohen kushtet, kriteret e aplikimit.

### **Neni 23**

#### **Përparësitë gjatë ndarjes të subvencioneve dhe granteve për bujqësi**

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve dhe granteve në bujqësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi:

- 1.1 Zonave me prioritet të identifikuar nga komuna;
- 1.2 Pjesëmarrjes së fermerit në bashkëfinancim, në përjashtim kur në ftesën publike është përcaktuar ndryshe;
- 1.3 Femrave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta dhe status të veçantë;
- 1.4 Aplikuesve që nuk kanë fituar më parë subvencione nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë nuk kanë qenë përfitues i një granti për bujqësi, të ndarë nga DEBPZHR i komunës, pushteti qendror ose nga ndonjë donator tjetër;
- 1.5 Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta, sipas vlerës jo më pak se 40%;
- 1.6 Projektet që gjenerojnë vende të reja pune.

### **Neni 24**

#### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për biznese për persona juridik**

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve dhe granteve nga lëmia e bujqësisë për bizneset dhe personat juridikë, përfshijnë:

- 1.1 Numrin identifikues të fermerit (NIF);
- 1.2 Certifikatën e biznesit;
- 1.3 Projektin ideor (i marrë në drejtori);
- 1.4 Fletëposedimin për patundshmëri;
- 1.5 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë dhe mbeturinave;
- 1.6 Dëshmi se nuk ka obligime ndaj komunës dhe ATK-së;
- 1.7 Konfirmimin nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit;
- 1.8 Dokumentin identifikues të aplikuesit;

- 1.9 Deklaratë se nuk është përfitues i një granti të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë, brenda vitit fiskal.

#### **Neni 25**

##### **Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për fermerë**

1. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve dhe granteve në lëmin e bujqësisë, për personat fizikë përfshijnë, duke mos u kufizuar:

- 1.1 Numrin identifikues të fermerit (NIF);
- 1.2 Projektin ideor (i marrë në drejtori);
- 1.3 Fletëposedimin për patundshmëri;
- 1.4 Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- 1.5 Dokumentin identifikues të aplikuesit;
- 1.6 Deklaratë se nuk është përfitues i një granti të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë, brenda vitit fiskal;
- 1.7 Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
- 1.8 Konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit.

#### **Neni 26**

##### **Transparenca në përkrahjen e fermerëve apo bizneseve**

1. Komuna publikon listën e aplikuesve dhe dokumentet përcjellëse sipas kritereve të paraqitura në shpallje.
2. Komuna publikon listën përfundimtare të përfituesve brenda 2 ditë pune, pas vendimit për ndarje të subvencioneve apo granteve nga komisioni kompetent.
3. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, rastin, fushën, fshatin-vendbanimin prej nga vijnë përfituesit.
4. Publikimi i vendimeve dhe përfituesve nga ndarja e subvencioneve apo granteve bëhet në ueb-faqen e komunës, në tabelën e shpalljeve, si dhe në vendet e frekuentuara në territorin e komunës.
5. Për secilin lloj të subvencionit bujqësor apo grante për biznese, drejtorja duhet të bëjë shpallje të veçantë publike dhe krahas kësaj duhet të vendosë kriteret bazë për aplikim.
6. Komuna përmes drejtorisë përkatëse është e obliguar të ofrojë informacione lidhur me procedurat e ndarjes së subvencioneve apo granteve dhe mënyrat e aplikimit për secilën palë të interesuar.

## Neni 27

### Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Komuna apo DEBPZHR (Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural) lidh kontratë me përfituesin apo përfituesit, në mënyrë që çdo shkelje e kontratës, nga të dy palët të sanksionohet.
2. Përfituesi nuk mund ta shesë, ta tjetërsojë, apo ta keqpërdorë në çfarëdo forme tjetër subvencionin apo grantin e përfituar.
3. Kryetari i komunës në dakordim me drejtorin e drejtorisë, vendos për themelimin e komisionit për përzgjedhjen e përfituesit ose përfituesve.
4. Komisionet e themeluara hartojnë formularët e veçantë të aplikimit për secilën fushë të përkrahjes.
5. Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa, si dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari e Zhvillim Rural e Komunës së Vushtrrisë.

## Neni 28

### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

  
Nasuf Aliu  
Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna Vushtrri  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



**Komisioni për përgatitjen e Draft-Rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat**

**PROCESVERBAL / RAPORT**

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës z., me numër protokollit 01-nr.83/22 për formimin e komisionit për përgatitjen e, draft –rregullores për ndryshim dhe plotësim të Rregullores (KKV) nr.03/2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat komisioni në përbërje nga: 1. Fatmir Feka, zyrtar Ligjor ne DEBPZHR, 2. Tefik Maloku, shef i sektorit te Bujqësisë 3. Mentor Hasani – anëtar i kuvendit, 4. Agim Bregaj-anetar i kuvendit dhe 5. Refik Maloku anëtar i kuvendit, ka hartuar draftin e kësaj rregulloreje në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12, shkronja “c” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008”; neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27 e datës 3 qershor 2018”, neni 36, paragrafi 3 i rregullores financiare Nr.01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike, neni 43, pika 4 dhe 6, Rregulloren e MF Nr.-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik, si dhe nenin 40, paragrafi 2, pika “a” të Statutit të komunës Pas hartimit të draftit të kësaj rregulloreje komfor Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, komisioni ka vënë në diskutim draftin e rregullores me njoftimet për konsultimet publike, të cilat janë publikuar në ueb faqen e komunës, gjithmonë duke i respektuar afatet e parapara me UA.

Me rastin e publikimit ne ueb faqen e komunës për vënien ne diskutim publik te draft-rregullores, komisioni ka vene ne dispozicion adresën zyrtare elektronike [fatmir.feka@rks-gov.net](mailto:fatmir.feka@rks-gov.net) për te gjithë te interesuarit rreth draft-rregullores.

Konsultimi publik është mbajt me date 16.05.2022 ne sallën e Kuvendit te Komunës ku kane marre pjese 22 persona.

Te gjithë te pranishmit i kane përkrah përkrahë ndryshimet ne këtë rregullore derisa Remzije Zekolli propozon qe nëse nuk ka pengesa ligjore te futet si pik përkrahja e gjinisë femërore me prioritet.

Baki Haradinaj kërkon që edhe kombajnerët në të ardhmen të përkrahen nga komuna.

Vushtrri 08.06.2022

Përpilojë: Tefik Maloku



Republika e Kosovë



Komuna e Vushtrisë

**Komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores (KKV) nr.03/20 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.**

Datë:28.04.2022

### PROCESVERBAL

I përpiluar me datë 28.04.2022, me rastin e takimit të komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores (KKV) nr.03/20 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Bazuar në vendimin 01nr.83/22 të datës 31.03.2022, për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores (KKV) nr.03/20 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, komisioni më datë 28.04.2022 është takuar në përbërje të plotë, ku ka zgjedhur kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin si në vijim:

Kryesues i komisionit u zgjodh z. Fatmir Feka ndërsa procesmbajtës z. Tefik Maloku. Në takim u vendos që komisioni nga dita e sotme të evidentoj ndryshim-plotësimet e dispozitave të rregullores dhe të përgatitë drafti "Propozim-ndryshimet e rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Procesmbajtësi : Tefik Maloku





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 83/22

Nr. i fq. / Br. sh -1-

Data: / Datum 31.03.2022

VUSHTRRIË - VUČITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" në lidhje me nenin 17, paragrafi 1, shkronja "a" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, si dhe nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 31 mars 2022, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES (KKV) NR.03/2020 PËR PÛRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për plotësim-ndryshimin e Rregullores Nr.03/2020 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, me nr. të protokollit 01.nr.45/20 i datës 27.2.2020, në këtë përbërje:

- 1.1 Mentor Hasani, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.3 Refik Maloku, anëtar i kuvendit (LVV);
- 1.4 Fatmir Feka, zyrtar ligjor në DEBPZHR dhe
- 1.5 Tefik Maloku, shef i Sektorit të bujqësisë.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi në takimin e parë, në përbërjen e tij duhet të zgjedhë kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë ndryshimplotësimet e dispozitave të rregullores dhe të përgatitë draftin "Propozim-ndryshimet e rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat".

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrrisë  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Drejtoria për Administratë

Konsultim publik për Draft-rregulloren për plotësim-ndryshimin e Rregullores për përkrashjen e fermerëve ne bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat

Date: 16.05.2022

Regjistri i Pjesëmarrësve

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendi	Nr. i telefonit	Nënskrimi
1	BASHIRI GAZI	YVCOSH VUSHTRIA	044 619 000	
2	Gjermani Adnan	KARAGË VUSHTRIA	044 671-135	
3	DEGJIT ZENELI	KOLL VUSHTRIA	045 892 725	
4	ILMI PIANA	DOLLAR	044-589 763	
5	SAFET FEKRI	KARAGË	044 198 331	
6	FATIR LATI	DUMAJE	044 13 6024	
7	Agonem Palear	DOKURIC		
8	Kompe Ipekole	MESHUMER	045-499-161	
9	Bujqi Idrizaj	VUSHTRIA	044-114 628	
10	GJICAZI IBEHIMI	AKRASHITÇE	044-258-424	
11	SABIT VATOVCI	KLOVOCANI	044-836 595	
12	Bajri Bajramaj		044-202-136	
13	Albi Ali		046 180 3443	
14	FLORENTINI	KOLL	046 172 559	
15	Dojic GASHI	VUSHTRIA	045462654	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Vushtrritë  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Drejtoria për Administratë

Konsultim publik për Draft-rregulloren për plotësim-ndryshimin e Rregullores për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat

Date: 16.05.2022

Regjistri i Presëmarrësve

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendi	Nr. i telefonit	Nënskrimi
1	Arta Januzi	Vushtrri	045-281472	
2	Shkëmbije Hake	Vushtrri	045-564-629	
3	Rolze Shkurt	Vushtrri	044-619-215	
4	SEVETE DECIU	VUSHTRR,	044-447-843	
5	FIDANE FAJIV	VUSHTRRI	049-838-826	
6	Mediana Gashi	Vushtrri	049-838-826	
7	Gejet Hyseni	Vushtrri	044-820846	
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Arsim

DATE /A:	17.06.2022
REFERENCË :	10 Nr. <u>650</u> 22
PËR:	KPF dhe KK të Komunës
CC:	
PËRMES:	
NGA:	znj. Miradije MALOKU, Drejtor i DKA-së
TEMA:	Informatë për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për nxënës



Në bazë të planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022 dhe të programit të punës së DKA-së për këtë vit, Drejtoria e Arsimit paraqet:

**Informatë për ndarjen e Bursave për studentët e Komunës së Vushtrrisë dhe shpërblime për nxënës për vitin 2022.**

Në bazë të nenit 74 të Statutit të Komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.267/19 të datës 26.09.2020, Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës, proto 01.nr.95/20, datë 30.04.2020, Drejtoria për Arsim ka shpallur konkursin me nr. prot. 10 Nr.237/22, më dt.30.03.2022, për vitin akademik 2021/22.

Nga ky konkurs bursën e fituan këta studentë:

**I. Bursa për fëmijë të dëshmorëve**

Për këtë kategori me konkurs janë ndarë 5(pesë) bursa, kanë aplikuar 3(tre) studentë

**Përfitues të bursës janë:**

1. Qlirimtare Arsim Tahiri - fëmijë i dëshmorit.
2. Albion Musa Hajrizi - fëmijë i dëshmorit.
3. Kaltrina Avni Saraçi - fëmijë i dëshmorit.

**II. Bursa për drejtime deficitare**

• **Fakulteti i SHMN –Matematikë**

Për këtë fakultet me konkurs janë ndarë 4(katër) bursa, kanë aplikuar 7(shtatë) studentë.

**Përfitues të bursës janë:**

1. **Erdin Osmani**, viti II-të i studimeve me notë mesatare 8.29, ka fituar 20 pikë.
2. **Altin Duraku**, viti II-të i studimeve me notë mesatare 8, ka fituar 20 pikë dhe 5 pikë si fëmijë i veteranit, gjithsej 25 pikë.
3. **Erëza Asllani**, viti II-të i studimeve me notë mesatare 8.11, ka fituar 20 pikë.

*Tre kandidatët e tjerë, nuk e fituan bursën komunale, pasi që e kishin notën mesatare nën notën 8(tetë), kurse kandidatja tjetër ishte në vitin e parë të studimeve.*

• **Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës**

a) **Departamenti i Ndërtimtarisë**

Për këtë departament me konkurs janë ndarë 4(katër) bursa, kanë aplikuar 11(njëmbëdhjetë) studentë.

**Përfitues i bursës është:**

1. **Festim Selimi**, viti III-të i studimeve me notë mesatare 8.65, ka fituar 20 pikë.

*Dy studentëve me notën mesatare mbi 8-të, nuk ju nda bursë komunale, sepse njëra studente ishte përsëritëse e vitit(hera e dytë e regjistrimit), kurse studenti tjetër ishte përfitues i bursës universitare.*

b) **Departamenti i Arkitekturës**

Për këtë departament me konkurs janë ndarë 6(gjashtë) bursa, kanë aplikuar 5(pesë) studentë.

**Përfitues të bursës janë:**

1. **Medina Zymeri**, viti III-të i studimeve me notë mesatare 8.65, ka fituar 20 pikë.
2. **Bardha Oshlani**, viti V-të i studimeve me notë mesatare 8.79, ka fituar 20 pikë.

*Kandidatët e tjerë ishin me notën mesatare nën notën 8(tetë).*

**III. Bursa për drejtime të tjera**

• **Fakulteti i Edukimit: Programi Fillor**

Për këtë program me konkurs janë ndarë 3(tre) bursa, kanë aplikuar 27(njëzet e shtatë) studentë.

**Përfitues të bursës janë:**

1. **Eronitë Kajtazi**, viti III-të i studimeve me notë mesatare 9, ka fituar 30 pikë dhe 5 pikë si fëmijë nga familja e të burgosurve politik, gjithsej 35 pikë.
2. **Donika Pllana**, viti III të i studimeve, me notë mesatare 9, ka fituar 30 pikë.  
1	Komunat duhet të kenë raportuar të dhënat në SMPK sipas afatit të përcaktuar.	PO, në qoftë se komuna ka raportuar në SMPK në afat të përcaktuar. JO, në qoftë se komuna ka raportuar në SMPK pas afatit të përcaktuar.		Po	Raporti SMPK 2020	
2	Komunat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishqyrtuar aktet komunale të vlerësuar si të kundërligjshme nga autoriteti mbikëqyres	PO, në qoftë se komuna ka rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuar si të kundërligjshme nga organet mbikëqyres sipas kërkesave ligjore. JO, në qoftë se komuna nuk ka rishqyrtuar të gjitha aktet komunale të vlerësuar si të kundërligjshme nga organet mbikëqyres sipas kërkesave ligjore.		Po	Raporti i funksionimit të komunave 2020	
3	Opinionet e auditimit duhet të jetë të paktën i pamodifikuar me theksim të çështjes;	PO, në qoftë se komuna marr: 1) opinionin të pamodifikuar, ose 2) opinionin të pamodifikuar me theksim të çështjes JO, në qoftë se komuna marr: 3) opinionin të kualifikuar 4) opinionin të kualifikuar me theksim të çështjes 5) opinionin të kundërt, ose 6) ZKA refuzon të japë opinionin		Po	Raporti vjetor i auditimit të komunës 2020	
4	Komunat duhet të kenë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale	PO, në qoftë se komuna ka shpenzuar së paku 75% ose më tepër të buxhetit final për investime kapitale JO, në qoftë se komuna ka shpenzuar më pak se 75% të buxhetit final për investime kapitale		Jo	Raporti vjetor i auditimit dhe shkresa e MFTP	74.03%

Shtojcë: % e treguesve sipas fushave

<b>Shërbimet Publike Administrative</b>			99.90
1.1.1	Kërkesat administrative të shqyrtuara gjatë vitit		99.90
1.1.2	Kërkesat administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore		99.79
1.1.4	Shërbimet administrative të ofruara në mënyrë elektronike nga komuna		100.00
2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online		100.00
2.1.2	Niveli i qasje në dokumente publike nga qytetarët		100.00
2.1.3	Përbushija e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës		100.00
2.1.4	Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqën zyrtare të komunës		100.00
2.1.5	Publikimi i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqën zyrtare të komunës		100.00
2.2.1	Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit		100.00
2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave		100.00
3.1.1	Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike		100.00
3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike		22.75
3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun		100.00
3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal		100.00
3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike		66.66
3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal		100.00
3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal		100.00
3.2.3	Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak		00
3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale		100.00
3.2.5	Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale		00.00
3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës		73.33
3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit		100.00
3.3.2	Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve		I ngritë
3.3.3	Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit		12.53
3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal		100.00
3.4.2	Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre		100.00
3.5.1	Zbatimi i skemës për shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbuesit civil		100.00
3.5.3	Kontratat për shërbime të veçanta janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore		100.00
<b>Përgjegjshmëria Komunale</b>			

Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare	4.1.1	Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione komunale	30.00
	4.1.2	Të punësuar nga komunitetet jo-shumicë	63.07
	4.2.1	Familje me nevojë të cilave iu është siguruar bamirë dhe janë krijuar kushtet për lëshim të bamirimit social	83.75
	4.2.2	Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar	100.00
Kulturë, Rini dhe Sport	5.1.1	Hapësira për aktivitete sportive për numër të banorëve	58.18
	6.1.1	Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive	88.88
Menaxhimi i fatkeqësive	6.1.2	Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë	100.00
	7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunitetit i mbuluar me plane rregulluese (të bollëshme)	00.00
Planifikimi Hapësinor	7.2.1	Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit	100.00
	7.2.2	Ndërtesa të reja të inspektuara	100.00
	7.2.3	Objekte të reja me leje të ndërtimit	100.00
	8.1.1	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike në m <sup>2</sup> për kokë banori	4.22
Hapësirat Publike	8.1.2	Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht	100.00
	8.1.3	Hapësirat publike të pajisura me ndriçim publik	88.88
	9.1.1	Rrugët lokale të shtrura	95.62
Infrastruktura Rrugore	9.1.2	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës	100.00
	9.1.3	Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit	100.00
	9.2.1	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me trotuare	23.72
	9.2.2	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me ndriçim publik	32.97
	9.2.3	Gjatësia e rrugëve lokale të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal	45.47
	9.2.4	Rrugët në zonën urbane me shëng të biçikletave	18.25
	9.2.5	Rrugët lokale të riasfaltuara	96.77
	10.1.1	Realizimi i planit komunal për transport lokal publik	100.00
Transporti Publik	10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	81.81
	10.1.3	Vendndalimet e shënjëzuara për automjetet e transportit publik	90.74
	11.1.1	Numri i parkimeve për parkimin e mjeteve motorike	29.00
Parkingjet Publike	11.1.2	Vendparkimet për mjete motorike në territorin e komunës	100.00
	11.1.3	Vendparkimet e destinuara për taksi	100.00
	11.1.4	Numri i parkingjeve me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara	89.65
	12.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit	100.00


<b>Uji i pijshëm</b>	12.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e ujit të pijshëm	79.00
<b>Kanalizimi</b>	13.1.1	Realizimi i planit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit	100.00
	13.1.2	Ekonomitë familjare, institucionet publike dhe njësitë biznesore të përfshira në sistemin e kanalizimit	81.60
<b>Menaxhimi i Mbeturinave</b>	14.1.1	Realizimi i planit komunal për menaxhinin e mbeturinave	100.00
	14.1.2	Ekonomitë familjare që kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave	100.00
	14.2.1	Realizimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave	96.43
	14.2.2	Inkasimi i mjeteve për mbledhjen e mbeturinave	75.16
	14.3.1	Sasia e deponimit të mbeturinave në kilogram për kokë banori	70.42
	15.1.1	Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis	80.00
<b>Mbrojtja e Mjedisit</b>	15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	100.00
	15.1.3	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale	95.23
	16.1.1	Gratë e punësuar në institucione/administratën komunale	97.33
<b>Përfaqësimi Gjinator</b>	16.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive	40.00
	16.1.3	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	16.66
	16.1.4	Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale	25.00
	16.1.5	Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale	2.95
	16.2.1	Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjeshëm gjinor	100.00
	16.2.2	Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave	41.65
	16.2.4	Plani komunal për barazi gjinore	100.00
	16.3.1	Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve	4.44
	16.3.2	Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive	3.01
	17.1.1	Çerdhe dhe kopshte në zona rurale për 10000 banorë	0.00
<b>Arsimi Parauniversitar</b>	17.1.2	m2 të hapësirave për nxënës – urban dhe rural	4.77
	17.1.3	Shkollat e paisura me kabinet të TJK	53.12
	17.1.4	Shkollat me masa të eficientës së energjisë	78.12
	17.1.5	Siguria në institucionet e arsimit parauniversitar	84.28
	17.1.6	Plotësimi i kushteve të kërkuara me infrastrukturë, pajisje dhe mjete në institucionet e arsimit parauniversitar	52.39
	17.2.1	Mësimdhënësit që i plotësojnë kriteret e kualifikimit të licencuar	84.01
	17.2.2	Niveli i pajtueshmërisë me raportin nxënës për mësimdhënëës - urban dhe rural	99.17
17.2.3	Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake	0.43	

	17.2.4	Plotësimi i vendeve të lira të punës në arsim me konkurs të rregullt	100.00
	17.3.5	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjimisë)	85.94
	17.3.7	Braktisja e shkollës nga nxënësit (shkalla inverse)	99.98
	18.1.1	m2 të hapësirave KPS për 10000 banorë	702.59
	18.1.2	Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	100.00
	18.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë	97.04
	18.2.2	Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vetanake	2.08
	18.3.1	Numri i vizitave të pacientiëve në kujdesin primar shëndetësor për kockë banori	25.06
	18.3.2	Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	99.98
	18.3.3	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	100.00
	19.1.1	Plani për zhvillim ekonomik lokal	100.00
	19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim	100.00
	19.1.3	Niveli i azhurmimit të regjistrit të tatimit në pronë	100.00
	19.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	79.60
<b>Kujdesi Primar Shëndetësor</b>			
<b>Zhvillimi Ekonomik Lokal</b>			

Shtojcë: Raporti i performancës së komunave, janar-dhjetor 2020



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Datë/a:	14.06.2022
Referenc-ë:	13.Nr.310/22
Për/Za/To:	Kuvendin Komunal
Nga/Od/From:	<b>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit</b> <b>Drejtori i drejtorisë: Fortuna Krasniqi Spahiu</b> 
Tema/Subjektat/Subject:	<b>Informatë rreth procedurës së legalizimit të ndërtimeve pa leje</b>

Të nderuar,

Drejtoria Për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka vazhduar me aktivitetet për udhëheqjen e procedurave për kërkesat të legalizimit për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi në kuadër të sektorit për legalizim.

Pas miratimit të Udhëzimeve Administrative që kanë të bëjnë me legalizimin e ndërtimeve pa leje, sektori i legalizimit ka pranuar kërkesat për legalizim të palëve të interesuara dhe vazhdimin e kërkesave të dorëzuara më parë. Do të vazhdohet me rishqyrtimin e lëndëve, plotësimin e dokumentacionit të lëndëve të trajtuara me aktivitetet paraprake të legalizimit të ndërtimeve pa leje, dhënien e qasjeve në aplikacionet e dorëzuara sipas programeve paraprake, ankesat e ndryshme të palëve, dhe kërkesave tjera. Do të vazhdojmë me pranimin në takim të qytetarëve të interesuar, për t'u konsultuar lidhur me ndryshimin/lehtësimin e procedurave të programeve paraprake dhe Ligjit nr. 06/L-024, dhe për kërkesa tjera.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa Leje Ndërtimore, sipas viteve të cekura më poshtë:

**Vitet 2015/2016**

Aplikacionet e pranuar janë: .....	84
Në procedurë të legalizimit janë .....	75
Të legalizuara janë .....	8
Lista e pritjes .....	1
Ankesa .....	0

**Viti 2020**

Aplikacionet e pranuar janë: .....	229
Në procedurë të legalizimit janë .....	72
Të legalizuara janë .....	140
Lista e pritjes .....	13
Ankesa .....	4

**Viti 2021**

Aplikacionet e pranuar janë: .....	505
Në procedurë të legalizimit janë .....	386
Të legalizuara janë .....	103
Lista e pritjes .....	3
Ankesa .....	13

## Viti 2022

Aplikacionet e pranuar janë: .....	102
Në procedurë të legalizimit janë .....	84
Të legalizuara janë .....	13
Lista e pritjes .....	0
Ankesa .....	5

## Rekapitullimi:

Aplikacionet e pranuar për legalizim janë gjithsejtë: .....	920
Në procedurë të legalizimit janë .....	627 aplikacione
Të legalizuara janë .....	254 objekte
Lista e pritjes .....	17 objekte
Ankesa .....	22

Të gjitha lëndët për legalizim që i kanë plotësuar kushtet janë dërguar në kadastër për regjistrim të objekteve të legalizuara në RDPP dhe janë kthyer konfirmimet nga Drejtoria për gjeodezi Kadastër dhe Pronë se objektet e legalizuara janë tashmë të regjistruara edhe në RDPP.

Takimet me palë kanë vazhduar rregullisht gjatë këtyre muajve. Takimet me palë janë zhvilluar rregullisht, çdo të martë dhe të enjte, nga ora 09.00-12.00.

## **Mangësitë**

- Mungesa të stafit profesionalë të mjaftueshëm në DUMM për shqyrtimin e lëndëve të legalizimit.
- Pandemia COVID-19, nga e cila janë prek pothuaj i gjithë stafi i Komunës dhe nevojës së reduktimit të stafit dhe punës me staf esencial gjatë vitit 2020 dhe 2021 nuk ka pas mundësi që të përcjellën afatet kohore për shqyrtimin e kërkesave të palëve për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje.

## **Aktivitete e planifikuara**

- Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara, në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për ndërtimet pa leje: të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, te kategorisë I dhe te kategorisë II, të cilat janë shtëpi; ndërtimet pa leje: të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi; Ndërtimet pa leje: të papërfunduara, të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi dhe ndërtimet pa leje të papërfunduara, të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Sigurimi i numrit të zyrtarëve-profesionistë me qëllim që të procedohen detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë në afatin sa më të shkurtër kohor, sfidat që presin ekipin tonë të zyrtarëve janë të mëdha, sepse kërkon staf të përgatitur mirë në aspektin profesional.
- Riorganizimi i punës në Drejtorinë e Urbanizmit, e cila funksionon në kuadër të Sektorit të legalizimit të kësaj drejtorie;
- Planifikohen vizita në teren për kërkesat e paraqitura.
- Do të vazhdohet me vetëdijesimin dhe fushatën informuese për palët e interesuara. Orari i pranimit të palëve për konsultime të lëndëve për legalizim do të jetë fleksibil.

Me respekt!





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUCITRN

<b>DATE</b>	<b>11.06.2022</b>
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Hava Mlinaku Drejtoare e Drejtorisë për Administratë</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Informatë për punën e drejtorisë, gjatë periudhës janar-qershor-2022</b>

Duke u bazuar në Planin e Punës të Kuvendit për vitin 2022, i cili parasheh që ne si drejtori të paraqesim informatë gjashtë mujore lidhur me punën dhe përgjegjësitë, drejtorja e sipërcekur bashkëngjit informatat e shërbimeve dhe punët e drejtorisë.

## Informatë për punën e drejtorisë, gjatë periudhës janar-qershor-2022

Informata për punën e Drejtorisë për Administratë përmban aktivitetet dhe detyrat, duke u bazuar në fushat dhe përgjegjësitë që drejtorja ka sipas Statutit të komunës, ligjeve dhe akteve tjera normative.

Drejtorinë për Administratë e përbëjnë këto njësi:

- Sektori i gjendjes civile;
- Qendra e shërbimeve për qytetarë;
- Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative;
- Zyra për të drejtat e njeriut.

Trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve më të mira, është në ngritje duke ju falënderuar angazhimit dhe punës rutinore që bëjnë gjithë zyrtarët e drejtorisë.

### Zyra e gjendjes civile

Zyra e gjendjes civile, duke u bazuar në Ligjin për gjendjen civile dhe aktet nënligjore që e rregullojnë fushën e gjendjes civile, kryen këto shërbime:

1. Përditësohet regjistri qendror i gjendjes civile;
2. Bëhet regjistrimi i të gjitha fakteve të lindjeve, vdekjeve dhe martesave;
3. Krijohen dhe mbahen aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;
4. Krijohet dhe lëshohet numri personal për qytetarët që janë të lindur në Komunën e Vushtrrisë;
5. Lëshohen të gjitha certifikatat dhe dokumente tjera të përcaktuara me Ligjin e gjendjes civile dhe UA;
6. Kryhen kurorëzimet e qytetarëve që janë banorë të Komunës së Vushtrrisë;
7. Bëhet pranimi i kërkesave për natyralizim (fitim) dhe për lirim të shtetësisë së Kosovës;
8. Bëhet lajmërimi dhe çlajmërimi i vendbanimit;
9. Bëhet përgatitja e raporteve mujore për të gjitha faktet e lindjeve, vdekjeve dhe martesave, si dhe i dërgohen Entit Statistikor;
10. Regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ndryshimet dhe korrigjimet e të dhënave personale për çdo qytetar në regjistrin fizik dhe elektronik;

Kryhen edhe shërbime tjera të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin e gjendjes civile dhe në aktet nënligjore në fuqi.

Zyra e gjendjes civile ka bërë përgatitjet edhe për pritjen e bashkatdhetarëve gjatë muajve të verës ku kërkesat për certifikata dhe për shërbime tjera nga gjendja civile janë më të mëdha, andaj me vendim të Kryetarit të komunës kemi filluar që të punojmë edhe të shtunave prej orës 10:00 deri në ora 14:00. Kemi caktuar 3 sportele të veçanta vetëm për bashkatdhetarët, me qëllim që të krijojmë kushte për trajtim sa më të mirë dhe për një shërbim sa më të shpejtë për mërgimtarët e komunës tonë. Edhe gjatë kësaj periudhe Zyra e gjendjes civile i ka marrë të gjitha masat që të zbatojë vendimin e MAPL-së për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin RAE. Njëherazi kjo zyrë ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë interes dhe nevojë për shërbime dhe në vazhden e këtij bashkëpunimi kemi

pasur shumë takime, konferenca dhe trajnime me organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Në vazhdimësi jemi duke bashkëpunuar ngusht me Gjykatat e Kosovës, Entin e Sigurimeve Pensionale të Kosovës dhe të shteteve të huaja dhe çdo kërkesë i përgjigjemi në kohë, brenda ditës ose sipas afateve që i cakton gjykata, ngase kërkesat e gjykatës janë gjithmonë me urgjencë dhe si të tilla edhe i trajtojmë.

Nga muaji janar e deri në përpilimin e kësaj informate, ju paraqesim tabelën e poshtëshënuar, e cila pasqyron në tërësi punën që është bërë në shërbim të qytetarëve.

Nr.	Lloji i certifikatës	Me pagesë	Të liruara nga pagesa	Totali
1.	Certifikatës i lindjes	4321	638	4959
2.	Ekstrakt nga regjistri qendror	9338	1553	10891
2.	Certifikata e martësës	2374	334	2708
3.	Certifikata e statusit martesor	768	103	871
4.	Certifikata e vendbanimit	1571	314	1885
5.	Certifikata e shtetësisë	770	169	939
6.	Deklarata e bashkësisë familjare	3018	589	3607
7.	Certifikata e vdekjes	150	22	172
8.	Vërtetimi nga arkiva	1691	278	1969
9.	Dëshmi e vdekjes	126	0	126
<b>Totali</b>		<b>24127</b>	<b>4000</b>	<b>28127</b>

**Regjistrimet e bëra në Zyrën e gjendjes civile:**

1	Regjistrime të lindjes	123
2	Martesa	338
3	Regjistrime të vdekjes	180
4	Regjistrime të shtetësisë	5
5	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	54
6	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	18
7	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	24
Gjithsej regjistrime të bëra		<b>742</b>

**Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve, janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa të ndryshme:**

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	10
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	19
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	18
3.	Vendime për korrigjimin e të dhënave personale në RQ	7
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	22
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	10
6.	Dëshmi të vdekjes	118
7.	Lajmërime dhe çlajmërime të adresës së vendbanimit	278
8.	Vendime për korrigjimin e akteve të lindjes,	3
9.	Vendime për korrigjimin e akteve të vdekjes	3
9.	Vendime për korrigjimin e akteve të martesës	0
10.	Aplikime për natyralizim (fitim të shtetësisë)	12
11.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	30
12.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	6
13.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	5
Gjithsej regjistrime të bëra		<b>541</b>

Ne këtë periudhë janë verifikuar **715** qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri më **19.02.2013** janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile **100670** qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

## Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative

Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e sistemit të teknologjisë informative të komunës, lektorimin e materialeve të organeve të komunës, përkthimi i materialeve zyrtare të komunës nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, si dhe asistimi në përkthimin simulant për nevoja të organeve të komunës, mirëmbajtjen e të gjitha stabilimenteve elektrike dhe teknike në ambientet e objekteve të komunës, ndërrimin dhe riparimin e stabilimenteve, montimin e pjesëve të reja sipas nevojës së parashtruar, si dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me logjistikë.

Sektori për punë të përbashkëta dhe teknologji informative sipas planit vjetor ka pasur 5 objektiva të përcaktuara, të përshkruara më lart, ku për arritjen e këtyre objektivave ka zhvilluar 15 aktivitete të tjera të paparapara sipas planit vjetor të veprimit. Të gjitha këto kanë dalë si rezultat i nevojave të administratës, në përmbushjen e obligimeve dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve ndaj qytetarëve.

<b>Përshkrimi i punëve, detyrave dhe intervenimeve të bëra</b>	
Formatizime, instalime të aplikacioneve apo softuerëve të ndryshëm apo zgjidhja e problemeve softuerike.	81
Mbështetje për personel në shfrytëzimin e resurseve të teknologjisë informative.	107
Zgjidhja e problemeve dhe defekteve të ndryshme.	51
Postime në ueb-faqe dhe mirëmbajtja e ueb-faqes zyrtare	13
Lektorimi i dokumenteve të ndryshme për të gjitha organet e komunës, si dhe konsultime për lektorim.	121
Shërbime përkthimi, përkthimi i dokumenteve apo përkthim simulant sipas nevojës të organeve komunale.	92
Riparime dhe punë të ndryshme për mirëmbajtje të objektit komunal.	214

Duhet potencuar që prej kalimit në objektin e ri të komunës kemi pasur probleme me sistemin e ngrohjes gjatë stinës së dimrit dhe me klimatizim gjatës stinës së verës, ku prej vitit të kaluar është

jashtë funksionit. Andaj është e nevojshme që të kemi mirëmbajtje për sistemet që kemi në objekt të komunës.

### **Qendra e shërbimeve të qytetarëve në komunë**

Qendra e shërbimeve të qytetarëve në komunë është përgjegjëse për:

1. Shërbimet e gjendjes civile, tatimit në pronë, regjistrimin e bizneseve, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet e tjera;
2. Përgatitjen dhe vënien në dispozicion të broshurave dhe fletëpalosjeve informative për qytetarët dhe publikimin në ueb-faqe;
3. Këshillimin dhe ndihmën juridike-administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtresave;
4. Pranimin dhe regjistrimin e kërkesave dhe parashtresave;
5. Mbajtjen e dosjeve, statistikave të parashtresave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarët;
6. Shtypjen e librit të protokollit nga sistemi i intranetit;
7. Vëzhgimin e reagimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve të komunës ndaj shërbimeve që ofron qendra;
8. Leximin dhe përcjelljen e lëndëve të paraqitura përmes platformës së intranetit;
9. Përcjelljen në mënyrën elektronike të lëndëve tek drejtorët përkatës dhe marrjen e përgjigjes;
10. Protokollimin e dokumenteve të komunës me numër unik të protokollit, përmes sistemit të intranetit.

**Gjatë kësaj periudhe Qendra për shërbim me qytetarë ka administruar gjithsej 29475 kërkesa, për të gjitha organet e komunës dhe drejtoritë, si vijon:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr. kërkesave</b>
1	Drejtoria për Administratë	16504
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	4079
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5441
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	119
5	Drejtoria për Shërbime Publike	454
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	939
7	Drejtoria për Arsim	346
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	337
9	Drejtoria për Inspektive	253
10	Personeli	590
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	51

12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	161
13	Zyra ligjore	30
14	Kryetari i Komunës	134
15	Drejtoria e Prokurimit	4
16	Kuvendi i Komunës	23
17	Zyra lokale e komuniteteve	7
18	Njësia e auditimit të brendshëm	3
		29475

Në kuadër të QSHQ-së, funksionon edhe qendra e thirrjeve pa pagesë, ku qytetarët mund të kontaktojnë me zyrtarët komunal për problemet lidhur me dokumentacione, kurse gjatë kësaj periudhe, kjo qendër ka pranuar 198 telefonata, për të cilat qytetarët janë informuar ose janë udhëzuar për në drejtori tjera.

### Njësiti komunal për të drejtat e njeriut

Ky njësiti koordinon, udhëheq dhe mbikëqyr politikat në komunë, në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë respektimin e politikave për barazinë gjinore, të drejtat e komuniteteve, përdorimin e gjuhëve, mundësitë e barabarta, zbatimin e politikave për personat me nevoja të veçanta, të drejtat e fëmijëve kundër diskriminimit dhe antitrafikimit.

#### Gjatë kësaj periudhe kemi pasur këto aktivitete:

- Përgatitja dhe dorëzimi i Planit të punës së NJKDNJ, tek MAPL dhe ABGJ;
- Dorëzimi i Raportit njëvjeçar të punës të ABGJ – Agjencioni për Barazi Gjinore tek Zyra e kryeministrit;
- Vizitë në terren me zyrtarin për komunitete;
- Dorëzimi i Planit të punës -2022- nga NJKDNJ tek MAPL dhe ABGJ;
- Pjesëmarrje në mbledhjen e KK Vushtrri;
- Pjesëmarrje në mbledhjen e KKSB;
- Pjesëmarrje në mbledhjen e KKRA;
- Plotësimi i pyetësorit nga ABGJ për çështjen gjinore;
- Dërgimi i statistikave në ABGJ lidhur me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve;
- Dërgimi i statistikave tek Zyra e kryeministrit për qeverisje të mirë, lidhur me Ligjin Kundër Diskriminimit;
- Takim në zyrë me palët e komunitetit rom;
- Vizitë në 10 shkolla fillore në Komunën e Vushtrrisë;
- Organizimi i takimit me gratë kryefamiljare, me temë »Të drejtat e tyre në pronësi«;
- Dërgimi i të dhënave për barazi gjinore të koordinatori për performancë;
- Pjesëmarrje në komisionin për hartimin e Rregullores për funksionalizimin e fshatrave;

- Raportimi për performancën komunale;
- Pjesëmarrje në punëtori lidhur me barazinë gjinore;
- Pjesëmarrje në punëtori lidhur me diskriminimin gjinor;
- Pjesëmarrje në punëtori kundër dhunës ndaj gruas;
- Organizimi i Ditës ndërkombëtare të gruas “8 Marsi”, marshimi >Stop dhunës ndaj gruas<;
- Organizimi i Ditës ndërkombëtare të fëmijëve, “1 Qershori”, vizitë Handikosit;
- ZKK vizitë komunitetit ashkali në Vushtri;
- Organizimi dhe mbajtja e tri dëgjimeve publike për hartimin e Rregullores për funksionalizimin dhe organizimin e fshatrave;
- Shqyrtimi i kërkesave kundër vërshimeve, në cilësinë e anëtares së komisionit të ankesave për dëmet e shkaktuara nga vërshimet;
- Pjesëmarrje në komisionin intervistues, lidhur me gradimin për zyrtaren për të drejta të njeriut.

**Deri në përpilimin e kësaj informate, Drejtoria për Administratë ka realizuar:**

Të hyrat nga shërbimet administrative	32.057.00 €
---------------------------------------	-------------







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

<b>DATË:</b>	<b>16.6.2022</b>
<b>PËR:</b>	<b>KPF dhe Kuvendin e Komunës</b>
<b>PËRMES:</b>	<b>Kryetarit të Komunës, Ferit Idrizi</b> 
<b>NGA:</b>	<b>Drejtoria për Buxhet dhe Financa</b> <b>Abit Abiti, ZKF:</b> 
<b>LËNDA:</b>	<b>Akt - përcjellës</b>

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur vlerësimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me vlerësimin e vendimit 95/22 të datës 28.04.2022 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021.

MAPL ka kërkuar që të bëhet rishqyrtimi i këtij vendimi në aspektin procedural, që paraprakisht të shqyrtohen nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Andaj, i propozojmë KPF-së që ta procedojë në kuvendin e komunës për rivotim.

Në shtojcë gjeni të bashkëngjitura:

Vendimin e kuvendit së bashku me tabelat financiare, si dhe vlerësimin e MAPL-së për këtë vendim.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRAN

01 Nr. / Br. 95/22

Nr. i Eq. / Br. sht. -1-

Data / Datum 28.04.2022

VUSHTRRI - VUČITRAN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri.**

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligjit Nr. 08/l-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **28 prill 2022**, merr këtë:

**VENDIM**

**PËR SHPËRNDARJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË TEJKALUARA PËR BUXHETIN E VITIT 2021**

1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në kategoritë ekomomike të cekura si më poshtë:

1.1 Mallra dhe shërbime .....	306,354.13 €
1.2 Shpenzime komunale.....	9,994.73 €
1.3 Subvencione dhe transfere.....	593,966.26 €
1.4 Investime kapitale.....	227,973.92 €

**Totali i mjeteve të tejkaluara.....1,138,289.04 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi  
  
Kryesuese e Kuvendit



## Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

### Komuna e Vushtrisë

Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën kategorit ekonomike (zërat)	Kategoria	BARTJA 2022
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	14,000.00
Administrata -Vushtrri	16324	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	37,000.00
Inspeksioni	16647	0411	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Prokurimi	16820	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	3,000.00
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	2,700.00
Buxhetimi	17524	0112	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Zjarrefiksati dhe inspektimet	18428	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	14,350.00
Menaxhimi I fatkeqsive natyrore	18468	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	19,000.00
Zyra lokale e Komuniteteve	19620	1090	22	13		Mallra dhe shërbime	4,000.00
Bujqësia	47024	0421	22	13		Mallra dhe shërbime	17,000.00
Shërbimet kadastrale	65120	0610	22	13		Mallra dhe shërbime	8,000.00
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtrri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	94,000.00
Administrata shëndetësi	73033	0760	22	13		Mallra dhe shërbime	1,729.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	13		Mallra dhe shërbime	74,250.00
Shërbimet sociale	75616	1040	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Shërbimet Kulturore	85024	0820	22	13		Mallra dhe shërbime	10,000.00
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	248,016.00
Arsimi parafillor - Qerdhja	92670	0911	22	13		Mallra dhe shërbime	75,418.01
Arsimi I Mesëm	94890	0922	22	13		Mallra dhe shërbime	22,668.30
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>675,131.31</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	10,000.00
Administrata	92120	0980	22	14		Shpenzimet komunale	4,504.93
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>14,504.93</b>
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	125,000.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	20		Subvencione dhe transferet	190,000.00
Bujqësia	47024	0421	22	20		Subvencione dhe transferet	230,000.00
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	20		Subvencione dhe transferet	78,700.00
Administrata	92120	0980	22	20		Subvencione dhe transferet	10,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	50,000.00
<b>Subvencione</b>							<b>693,700.00</b>
<b>Kapitale</b>							<b>1,190,675.47</b>
<b>TOTALI</b>							<b>2,574,011.71</b>

*(Signature)*  
Abit Abiti

Zyrtar Kryesor Financiar

## Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

Komuna: Komuna e Vushtrrisë								
	Programi	Kodi I nën-programit	Kodi Funksional	Fondi Burimor	Kategori a ekonomike	Kodi I projektit	Projektet	BARTJA 2022
1	Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	43890	Inventar për objektin e ri të komunës	4,200.00
2	Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	52186	Ndërtimi i sallës në objektin e komunës	121,000.00
3	Administrata - Vushtri	16324	0133	22	30	49479	Ndërtimi i depozë	30,000.00
4	Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	41407	Ndërtimi i trotuareve	2,500.00
5	Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	43900	Projektet në bashkëfinancim me donatorë	21,194.80
6	Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	46628	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit Studime	21,205.81
7	Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	47932	Rregullimi i varrezave të martirëve Vushtri	5,192.00
8	Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	51202	Rindërtimi i rrugëve me infrastrukturë "Nexhip dhe Ferat Drag	1,125.82
9	Infrastrukturë publike	18184	0451	22	30	51826	Blerja e veturave për administratën komunale – Vushtri	10,000.00
10	Zjarrfikësit dhe inspeklimet	18428	0320	22	30	52187	Renovimi i objektit të zjarrfikësve	5,000.00
11	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	49561	Projektet në bashkëfinancim me donatorë	87,081.00
12	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	51203	Ndërtimi i kanaleve kulluese në Lumadh dhe Dumnicë e Ulët	5,439.65
13	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	51204	Rr. i shtr. të lume. në Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë të Mes	8,085.00
14	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30	51935	Regullimi i arginaturave të lumit "Silnica"	16,360.58
15	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	41424	Ndërt. rrug. lokale në fshatra -Pantinë, Dumnicë	161,998.30
16	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	45265	Asfaltimi i rrugëve në qytet	43,525.58
17	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	52188	Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc	100,000.00
18	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	49579	Rregullimi i hapësirave publike – shesheve	5,552.57
19	Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30	49598	Mbjellja e drunjve dekorativ Pestovë	13,044.33
20	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	52192	Rregullimi i hapësirave të rëntgenit - QKMF "Dr Safet Idrizi"	50,000.00
21	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	41427	Ndërtimi i QKMF në Vushtri	2,827.59
22	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	52189	Ndërtimi i depozë për mbeturina medicinale	2,060.00
23	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	52190	Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF	85,940.00
24	Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	50059	Automjetet i terrenit për shëndetësi	30,000.00
25	Shërbimet sociale	75616	1040	22	30	49628	Renovimi i qendrës për kujdes ditor për të moshuar	20,000.00
26	Shërbimet Rezidenciale	75617	1060	22	30	50984	Renovimi i qendrës rezidenciale Lumadh	3,900.00
27	Shërbimet kulturore	85024	0820	22	30	46840	Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi"	50,000.00
28	Shërbimet kulturore	85024	0820	22	30	48361	Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit i futbollit faza II	10,510.00
29	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	52191	Ndërtimi i shkollës në Gllavatit	147,000.00
30	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	41440	Ndërtimi i rrethojave në shkolla	2,878.14
31	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	46587	Fusha sportive "Migjeni " Stanoc	11,949.40
32	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	90282	Meremetimi i shkollave	5,541.94
33	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51008	Ndërtimi i toaleteve në shkolla	2,229.00
34	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	47970	Salla sportive	22,280.00
35	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	47909	Ndërtimi i çerdhes së re	39,557.60
36	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51868	Meremetimi i SHF. "Ali Kelmendi" –Sudime	10,000.00
37	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51873	Meremetimi i SHFMU "Azem Bejta" - Beçiq	4,000.00
38	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51858	Depo për shf. "Naim Frashëri" Vushtri	7,796.36
39	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51859	Depo për shf. „Latif Berisha"	1,400.00
40	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51860	Depo për shf. „Mustafë Shyti" Oshlan	1,400.00
41	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51865	Meremetimi i shfmu. "Lumni Surdulli" Samadrexhë	6,000.00
42	Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	51872	Meremetimi i shf "Naim Frashëri" dhe ndërtimi i toaleteve	11,000.00
							<b>TOTAL KAPITALE</b>	<b>1,190,675.47</b>

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

  
 Abit Abiti  
 Zyrtar Kryesor Financiar



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për :	<b>Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë</b> <b>Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<b>Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së</b> <b>Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së</b>	
Nga:	<b>Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave</b>	Datë: 26.05.2022
Zyrtarët përgjegjës:		Nr: VI-020-413
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	<b>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave</b>	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	<b>Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave</b>	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	<b>Vendimin Nr 95/22 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021</b>	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues/e,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 80.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 10.05.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë **Vendimin Nr 95/22 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021**, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, kërkon:

## Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

*Vendim Nr 95/22 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.*

### Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022, ka miratuar *Vendimin Nr 95/22 për shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2021*, i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë .

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë është në kundërshtim me Nenin 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, ku parashihet se të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, për mbajtjen e mbledhjes dhe rendin e ditës, ashtu siç kërkohet 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Gjithashtu ky vendim para se të shkojë për miratim në Kuvendin e komunës duhet të trajtohet në Komitetin për Politikë dhe Financa, si trup përgjegjës i Kuvendit për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare. Vendimi në fjalë, nuk është shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, siç parashihet në nenin 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimin të kërkesës për rishqyrtim të aktit.



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

<b>DATË:</b>	16.6.2022
<b>PËR:</b>	KPF dhe Kuvendin e Komunës
<b>PËRMES:</b>	<i>për</i> Kryetarit të Komunës, Ferit Idrizi 
<b>NGA:</b>	Drejtoria për Buxhet dhe Financa Abit Abiti, ZKF: 
<b>LËNDA:</b>	Akt - përcjellës

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur vlerësimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me vlerësimin e vendimit 96/22 të datës 28.04.2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.

MAPL ka kërkuar që të bëhet rishqyrtimi i këtij vendimi në aspektin procedural, që paraprakisht të shqyrtohen nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Andaj, i propozojmë KPF-së që ta procedojë në kuvendin e komunës për rivotim.

Në shtojcë gjeni të bashkëngjitura:

Vendimin e kuvendit së bashku me tabelat financiare, si dhe vlerësimin e MAPL-së për këtë vendim.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	96/22
Nr. i sq. / Br. st	-4-
Data: / Datum	28.04.2022
VUŠTRRI - VUČITRN	



## Republika e Kosovës

## Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 6, pika 2 të Ligji Nr. 08/I-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit-Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41, paragrafi 2, shkronja "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 28 prill 2022, merri këtë:

### VENDIM

### PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2021 NË VITIN 2022

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022 në kategoritë si në vijim:

1.1 Mallra dhe shërbime .....	675,131.31 €
1.2 Shpenzime komunale.....	14,504.93 €
1.3 Subvencione dhe transfere.....	693,700.00 €
1.4 Investime kapitale.....	1,190,675.47€
<b>Totali i mjeteve të bartura.....</b>	<b>2,574,011.71 €</b>

#### 1.1 Në kategorinë e Mallrat dhe shërbimet

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej 14,000.00 €  
Administrata (16324), shuma prej 37,000.00 €  
Inspektimet (16647), shuma prej 10,000.00 €  
Prokurimi (16820), shuma prej 3,000.00 €  
Zyra e Kuvendit Komunal (16924), shuma prej 2,700.00 €  
Buxhetimi (17524), shuma prej 10,000.00 €  
Zjarrfikësit dhe Inspektimet (18428), shuma prej 14,350.00 €  
Menaxhimi i katastrofave natyrore (18468), shuma prej 19,000.00 €  
Zyra komunale për komunitete dhe kthim (19620), shuma prej 4,000.00 €  
Bujqësia (47024), shuma prej 17,000.00 €  
Shërbimet kadastrale (65120), shuma prej 8,000.00 €  
Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), shuma prej 94,000.00 €  
Administarta (73033), shuma prej 1,729.00 €  
Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej 74,250.00 €



Shërbimet Sociale-Vushtrri (75616), shuma prej 10,000.00 €  
Shërbimet kulturore (85024), shuma prej 10,000.00 €  
Administrata (92120), shuma prej 248,016.00 €  
Arsimi parshkollor (92670), shuma prej 75,418.01 €  
Arsimi i mesëm i lartë (94890), shuma prej 22,668.30 €.

### 1.2. Në kategorinë e Shpenzimet komunale

Infrastruktura publike (18184), shuma prej 10,000.00 €  
Administrata (92120), shuma prej 4,504.93 €

### 1.3. Në kategorinë e Subvencionet dhe Transferet

Zyra e kryetarit (16024), shuma prej 125,000.00 €  
Infrastruktura publike (18184), shuma prej 190,000.00 €  
Bujqësia (47024), shuma prej 230,000.00 €  
Administrata (73033), shuma prej 10,000.00 €  
Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej 78,700.00 €  
Administrata (92120), shuma prej 10,000.00 €  
Shërbimet kulturore (85024), shuma prej 50,000.00 €

### 1.4. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale

#### **Administrata (16324), në projektet:**

Inventar për objektin e ri të Komunës kodit (43890), shuma prej 4,200.00 €  
Ndërtimi i sallës në objektin e Komunës (i ri), shuma prej 121,000.00 €  
Ndërtimi i deponisë kodit (49479), shuma prej 30,000.00 €

#### **Infrastruktura publike (18184), në projektet:**

Ndërtimi i trotuareve kodit (41407), shuma prej 2,500.00 €  
Projektet në bashkëfinansim me donator kodit (43900), shuma prej 21,194.80 €  
Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit kodit (46628), shuma prej 21,205.81 €  
Rregullimi i varrezave të martirëve kodit (47962), shuma prej 5,192.00 €  
Rindërtimi i rrugëve me infrastrukturë kodit (51202), shuma prej 1,125.82 €  
Blerja e veturave për administratën komunale –Vushtrri kodit (51826), shuma prej 10,000.00 €

#### **Zjarrfikësit dhe Inspektimet (18428), në projektin:**

Renovimi i objektit të zjarrfikësve (i ri), shuma prej 5,000.00 €

**Bujqësia (47024), në projektet:**

Projektet në bashkëfinancim me donatorë kod (49561) ), shuma prej 87,081.00 €

Ndërtimi i kanaleve kulluese në Lummadh dhe Dumnicë e Ulët kod (51203), shuma prej 5,439.65 €

Rr. i shtr. të lume. Në Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë e Mesme kod (51204), shuma prej 8,085.00 €

Regullimi i arginaturave të lumit "Silnica" kod (51835), shuma prej 16,360.58 €

**Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), në projektet:**

Ndërt. rrug. lokale në fshatra kod (41424), shuma prej 161,998.30 €

Asfaltimi i rrugëve në qytet kod (45265), shuma prej 43,525.58 €

Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakove (I ri), shuma prej 100,000.00 €

Rregullimi i hapësirave publike – shesheve kod (49579), shuma prej 5,552.57 €

Mbjellja e drunjve dekorativ kod (49588), shuma prej 13,044.33 €

**Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), në projektet:**

Rregullimi i hapësirave të rëntgenit - QKMF "Dr. Safet Idrizi" (i ri), shuma prej 50,000.00 €

Ndërtimi i QKMF në Vushtrri kod (41427), shuma prej 2,827.59 €

Ndërtimi i deposë për mbeturina medicinale (i ri), shuma prej 2,060.00 €

Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF (i ri), shuma prej 85,940.00 €

Automjet i terrenit për shëndetësi kod (50059), shuma prej 30,000.00 €

**Shërbimet Sociale-Vushtrri (75616), në projektin:**

Renovimi i qendrës për kujdes ditor për të moshuar kod (49628), shuma prej 20,000.00 €

**Shërbimet Rezidenciale – Vushtrri (75617), në projektin:**

Renovimi i qendrës rezidenciale kod (50984), shuma prej 3,800.00 €

**Shërbimet kulturore (85024), në projektet:**

Renovimi i stadiumit të hendbollit "Musa Abazi" kod (46840), shuma prej 50,000.00 €

Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumi i futbollit (Faza II) kod (48361), shuma prej 10,510.00 €

**Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93690), në projektet:**

Ndërtimi i shkollës në Gllavotin (i ri), shuma prej 147,000.00 €

Ndërtimi i rrethojave në shkolla kod(41440), shuma prej 2,878.14 €

Fusha sportive kod (46587), shuma prej 11,949.40 €

Meremetimi i shkollave kod (90282) ), shuma prej 5,541.94 €

Ndërtimi i tualeteve në shkolla kodi (51008) ), shuma prej 2,229.00 €  
Salla sportive kodi (47970) ), shuma prej 22,280.00 €  
Ndërtimi i çerdhes së re kodi (47909) ), shuma prej 39,557.60 €  
Meremetimi i SHF. "Ali Kelmendi" –Sudime kodi (51868), shuma prej 10,000.00 €  
Meremetimi i SHFMU "Azem Bejta" – Beçiq kodi (51873), shuma prej 4,000.00 €  
Depo për SHF. "Naim Frashëri" -Vushtri kodi (51858), shuma prej 7,796.36 €  
Depo për SHF „Latif Berisha" kodi (51859), shuma prej 1,400.00 €  
Depo për SHF „Mustaf Shyti" Oshlan kodi (51860) ), shuma prej 1,400.00 €  
Meremetimi i SHMU "Lumni Surdulli" kodi (51864), shuma prej 6,000.00 €  
Meremetimi i SHF "Naim Frashëri" dhe ndërtimi i tualeteve kodi (51872) ), shuma prej 11,000.00 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



## Bartja e mjeteve të tejkaluara gjatë vitit 2021

### Komuna e Vushtrisë

Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi FunkSIONAL	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Nën-kategori (zërat)	Kategoria	BARTJA 2022
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushtri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	59,697.62
Administrat-Arsimi	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	246,656.51
<b>Mallra dhe shërbime</b>							<b>306,354.13</b>
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzimet komunale	9,994.73
<b>Shpenzime komunale</b>							<b>9,994.73</b>
Zyra e kryetari	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transferet	74,912.36
Infrastruktura publike	18184	0451	22	20		Subvencione dhe transferet	190,000.00
Bujqësia	47024	0421	22	20		Subvencione dhe transferet	192,670.00
Administrata	73033	0760	22	20		Subvencione dhe transferet	8,514.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	20		Subvencione dhe transferet	77,400.00
Administrata	92120	0980	22	20		Subvencione dhe transferet	8,999.90
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	20		Subvencione dhe transferet	41,470.00
<b>Subvencione</b>							<b>593,966.26</b>
Shërbimet e shëndetësisë primare	74450	0721	22	30	I RI	Ndërtimi i zyrtave administrative në QKMF	85,940.00
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	93690	0912	22	30	I RI	Ndërtimi i shkollës në Gllavatim	147,000.00
<b>Kapitale</b>							<b>227,973.92</b>
<b>TOTALI</b>							<b>1,138,289.04</b>

Abit Abiti

Zyrtar Kryesor Financiar



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	<b>Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë</b> <b>Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	<b>Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së</b> <b>Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së</b>	
Nga:	<b>Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave</b>	Datë: <b>26.05.2022</b> Nr: <b>VI-020-413</b>
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	<b>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave</b>	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	<b>Ardita Latifi, Zyrtarë e lartë për Monitorimin e Komunave</b>	
Lënda:	<b>Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>	
Lloji i aktit:	<b>Vendimin Nr 96/22 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022</b>	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues/e,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 80.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 10.05.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë, **Vendimin Nr 96/22 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022**, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, kërkon:

## Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

*Vendimi Nr 96/22 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022*, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

### Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 28.04.2022, ka miratuar *Vendimi Nr 96/22 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022*, i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë .

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë është në **kundërshtim** me Nenin 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, ku parashihet se të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, për mbajtjen e mbledhjes dhe rendin e ditës, ashtu siç kërkohet 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Gjithashtu ky vendim para se të shkojë për miratim në Kuvendin e komunës duhet të trajtohet në Komitetin për Politikë dhe Financa, si trup përgjegjës i Kuvendit për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare. Vendimi në fjalë, nuk është shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, siç parashihet në nenin 52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimin të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

<b>DATË:</b>	27.06.2022
<b>PËR:</b>	Kuvendin e Komunës
<b>PROPOZUES:</b> <i>per</i>	Ferit Idrizi Kryetar i Komunës së Vushtrrisë <i>[Signature]</i>
<b>HARTUES:</b>	Komisioni për përgatitjen e Draft Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane; Fatmir Feka ,kryesues i komisionit <i>[Signature]</i>
<b>TEMA:</b>	Akt – përcjellës

Të nderuar,

Pas rekomandimeve nga ana e Kuvendit të Komunës për korrigjimin e Draft- Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, komisioni ua përcjell draftin e korrigjuar sipas rekomandimeve.

Bashkangjitur me këtë akt përcjellës e keni edhe propozimin për ndarjen e lagjeve në qytet nga komisioni i themeluar nga Kuvendi i Komunës për këtë çështje.

Me respekt!



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna Vushtrri**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



### **Kuvendi i Komunës**

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.28/2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 41, paragrafi 41.2, pika e e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_, miratoi këtë:

#### **DRAFT**

### **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregullojë organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në themelimin e këshillave lokale, në ushtrimin e aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje përfshinë të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Vushtrrisë dhe përcakton themelimin, formën dhe mënyrën e bashkëpunimit të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, duke formuar këshilla lokale, si trupa mbështetës të komunës dhe që të ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

#### **Neni 3**

##### **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1 **Këshillat lokale** – nënkupton trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.



1.2 **Kryetar i këshillit** – nënkupton personin me të votuar në tubim zgjedhor në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

#### **Neni 4 Formimi i këshillave lokale**

Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Komuna e Vushtrrisë do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokale. Një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivele të këshillave lokale dhe janë parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 5 Komisioni për përzgjedhjen e këshillave lokale**

1. Kuvendi i komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Ky përfaqësues zgjedhet ad-hoc nga komisioni.
2. Komisioni duhet të reflektojë përfaqësim gjinor dhe etnik. Nga shtatë (7) anëtarët e komisionit, përfaqësimi gjinor do të jetë tre (3) me katër (4) të gjinive të kundërta.
3. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të komunës.
4. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës.
5. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetar të këshillave lokale.
6. Së paku pesë (5) anëtarë të komisionit, prej të cilëve së paku dy (2) përfaqësues nga Kuvendi i komunës, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.
7. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
8. Komisioni i raporton Kuvendit të komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.

## **Neni 6**

### **Këshillat lokale në Komunën e Vushtrrisë**

**6.1** Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019, neni 4, paragrafi 2, në territorin e Komunës së Vushtrrisë themelohen këta këshilla lokale si më poshtë:

- 6.1.1. Këshilli lokal Qendra;
- 6.1.2. Këshilli lokal Kalaja;
- 6.1.3. Këshilli lokal Ura e Vjetër e Gurit;
- 6.1.4. Këshilli lokal Dardania;
- 6.1.5. Këshilli lokal Vicianë;
- 6.1.6. Këshilli lokal Silnica;
- 6.1.7. Këshilli lokal Iliria
- 6.1.8. Këshilli lokal Karaçë: Karaçë, Miraçë, Shlivovicë, Gumnishtë, Skromë, Boshlan, Kurilovë dhe Vesekoc;
- 6.1.9. Këshilli lokal Begaj: Begaj dhe Gojbulë;
- 6.1.10. Këshilli lokal Studime e Poshtme: Studime e Poshtme, Studime e Epërme, dhe Skoçan;
- 6.1.11. Këshilli lokal Nedakoc:, Nedakoc, Pestovë, Mavriq, Svaraçak i Poshtëm, dhe Svaraçak i Epërm
- 6.1.12. Këshilli lokal Maxhunaj: Maxhunaj, Ropicë, dhe Vilanc;
- 6.1.13. Këshilli lokal Samadrexhë: Samadrexhë, Ceceli, Sllakoc, Kunovik dhe Zagorë;
- 6.1.14. Këshilli lokal Dumnicë e Poshtme: Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Llugës dhe Dumnicë e Epërme;
- 6.1.15. Këshilli lokal Stanoc i Epërm: Stanoc i Epërm dhe Gracë;
- 6.1.16. Këshilli lokal Stanoc i Poshtëm: Stanoc i Poshtëm dhe Lumadh;
- 6.1.17. Këshilli lokal Prelluzhë; Prelluzhë
- 6.1.18. Këshilli lokal Stroc: Stroc, Bivolak, Zhilivodë, Gllavatin dhe Beçuk
- 6.1.19. Këshilli lokal Druar: Druar, Mihaliq Reznik, dhe Shalë
- 6.1.20. Këshilli lokal Novolan: Novolan, Brusnik Kollë, Bukosh dhe Verrnic ;
- 6.1.21. Këshilli lokal Duboc: Duboc, Beçiq, Taraxhë dhe Galicë;
- 6.1.22. Këshilli lokal Akrashtic: Akrashtic, Jezerë, dhe Balincë;
- 6.1.23. Këshilli lokal Dalak:, Dalak dhe Shtitaricë;
- 6.1.24. Këshilli lokal Pantinë: Pantinë, Oshlan dhe Hercegovë;
- 6.1.25. Këshilli lokal Smrekonicë: Dobërlukë; Smrekonicë, Banjskë, Sllatinë, Pasomë dhe Tërlllobuq.

**6.2.** Kufijtë territorial të lagjeve urbane janë përcaktuar me propozim nga komisioni i Kuvendit të Komunës për emërtimin dhe përcaktimin e kufijve të lagjeve urbane.

## Neni 7

### Njoftimi për organizimin e takimeve për përzgjedhjen e këshillave lokale

1. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i komunës, përmes zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë, për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
  - 1.1. Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe hapësirat më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen takimet për zgjedhjen e këshillave lokale;
  - 1.2. Mediave lokale;
  - 1.3. Ueb-faqes zyrtare të komunës;
  - 1.4. Platforma tjera të komunikimit.
2. Njoftimi për publikun duhet të përmbajë rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit.

## Neni 8

### Përbërja e këshillave lokale

1. Këshilli lokal mund të ketë nga pesë (5) deri nëntë (9) anëtarë. Numri i anëtarëve për secilin këshill lokal, përcaktohet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane që janë të pranishëm në takimin zgjedhor.
2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal me se paku 1 (një) anëtar. Në raste kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, atëherë fshati apo lagja urbane me numër më të madh të banorëve, përfaqësohet me 1 (një) anëtar më shumë se fshatrat tjerë të këshillit lokal.
3. Anëtarë të këshillave lokale zgjedhen kandidatët, të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve me të drejtë vote të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në takim zgjedhor.
4. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të qytetarëve që marrin pjesë në takim.
5. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.
6. Nënkryetari i këshillit zgjidhet nga kryesia e këshillit në takimin e parë të radhës pas themelimit të këshillit lokal. Për mënyrën e votimit të zgjedhjes së nënkryetarit vendos kryesia e këshillit lokal.
7. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publik në ueb-faqen zyrtare të komunës dhe platformat tjera të komunikimit menjëherë pas takimit zgjedhor.
8. Procesverbali i hartuar nga takimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në takim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje tjera të adresuara në takim.
9. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi i takimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi.

## **Neni 9**

### **Kriteret e përzgjedhjes për këshillat lokale**

1. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.
2. Kandidatët për anëtarë dhe kryetarë të këshillave lokale nuk mund të jenë kandidatë nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike.
3. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të propozojë së paku dy kandidatë për përfaqësim në këshillin lokal.
4. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 30 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, duke respektuar kuotën gjinore prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, dhe përfaqësimin etnik në lokalitete ku ka banorë të komuniteteve jo shumicë.
5. Përbërja e këshillave lokale duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore sipas nenit 9, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
6. Në këshillin lokal përfaqësohet edhe komuniteti jo shumicë me numër më të madh të banorëve të atij lokaliteti, të cilët janë të pranishëm në takim dhe votojnë.
7. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në takimin e qytetarëve.

## **Neni 10**

### **Komisioni i ankesave**

1. Kuvendi i komunës themelon komisionin e ankesave i cili i shqyrton ankesat lidhur me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.
2. Komisioni i ankesave do të ketë 3 anëtarë, të cilët zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e komunës.
3. Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor.
4. Ankesat për parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten tek komisioni për ankesa brenda 3 ditëve të punës.
5. Komisioni i ankesave është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e parashtrimit të ankesës t'ju kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.
6. Vendimet e komisionit të ankesave janë përfundimtare në procedurën administrative dhe të obligueshme për palët.
7. Komisioni i ankesave i raporton Kuvendit të komunës.

## **Neni 11**

### **Mandati i këshillave lokale**

1. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vjet.
2. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon si në vijim:
  - 2.1 me përfundimin e mandatit;
  - 2.2 nëse jep dorëheqje;
  - 2.3 nëse shkarkohet;
  - 2.4 nëse ndërron vendbanimin;
  - 2.5 në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër;
  - 2.6 Nëse vdes.
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale bëhet sipas procedurës së zgjedhjes.
4. Inicimi i procedurës për shkarkimin e kryetarit të këshillit bëhet me shumicën e anëtarëve të këshillit lokal dhe me peticion të nënshkruar më së paku prej 30 qytetarëve të atij lokaliteti.
5. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit lokal, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditë kalendrike duhet të organizojë zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
6. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes, me aprovimin e komisionit të kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.

## **Neni 12**

### **Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale**

1. Kryetari i komunës në bashkëpunim me kryesuesin e kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me kryetarët e këshillave lokale.
2. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike me qytetarë.
3. Kuvendi i komunës duhet të bëjë konsultime me këshillin lokal, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

## **Neni 13**

### **Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokale**

1. Me kërkesë të këshillit lokal dhe rekomandim të Kryetarit të komunës, apo ndonjë komiteti të kuvendit, Kuvendi i komunës me vendim të veçantë mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale. Aktivitetet që mund të transferohen, duhet të jenë kompetencë ekskluzive, vetanake të komunës.

2. Këshilli lokal duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna.
3. Bartja e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal duhet të mbështetet me financim dhe burime tjera të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sipas përgjegjësisë të bartura.

#### **Neni 14**

#### **Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit lokal**

1. Këshilli lokal mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet me interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Në mënyrë që kërkesat e qytetarëve të përcjellën rregullisht tek organet kompetente në komunë, këshilli lokal obligohet që të organizojë së paku një takim me qytetarë brenda një viti dhe sipas nevojës. Numri i takimeve të këshillit lokal sqarohet më tej në nenin 17, paragrafin 5 të kësaj rregulloreje.
3. Këshilli lokal duhet të organizojë, hartojë dhe përcjellë prioritetet dhe kërkesat e lokalitetit te Kryetari, Kuvendi i komunës dhe drejtoritë komunale.
4. Këshilli lokal duhet të informojë komunën për kohën, vendin dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët kompetent komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
5. Takimet e qytetarëve organizohen me iniciativën e këshillit lokal.
6. Këshilli lokal mund të ndërmarrë këto aktivitete, të cilat në veçanti ndikojnë në:
  - 6.1 Planifikimin urban dhe rural;
  - 6.2 Furnizimin me ujë;
  - 6.3 Rregullimin e kanalizimit, drenazhimi;
  - 6.4 Rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda këshillit lokal;
  - 6.5 Shëndetësinë publike;
  - 6.6 Mbrojtjen lokale të ambientit;
  - 6.7 Turizmin;
  - 6.8 Hapësirat publike dhe varrezat;
  - 6.9 Aktivitetet kulturore, arsimore dhe sportive;
  - 6.10 Aktivitetet vullnetare në interes për këshillin lokal;
  - 6.11 Mirëqenien e banorëve të këshillit lokal – sigurimi i të dhënave për çdo familje, duke përcjellë gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime për mbështetje të këtyre rasteve.
  - 6.12 Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizatat tjera të shoqërisë civile – organizata joqeveritare, shoqata, klube etj., për çështje me interes për lokalitetin.
  - 6.13 Zbatimin e aktiviteteve që janë bartur, sipas procedurave të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

7. Me pëlqimin e Kryetarit të komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve për monitorimin, zbatimin e projekteve për investime kapitale në lokalitetin e tyre.
8. Këshillat lokale kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e Komunës së Vushtrrisë.
9. Këshillat lokale kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë me shkrim, qoftë fizikisht apo përmes postës elektronike zyrtare, organeve kompetente të komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, dhe komuna i përgjigjet brenda afatit prej 30 ditësh.
10. Në raste emergjente, Këshilli lokal shndërrohet në nënshtab emergjent.

### **Neni 15**

#### **Roli i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e komunës.
2. Kryetari i këshillit lokal ka obligim t'i informojë anëtarët e këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet me organet e komunës.
3. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjen e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit.
4. Kryetari i këshillit lokal nënshkruan konkluzionet, propozimet dhe kërkesat e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre t'i adresojë në zyrën e Kryetarit të komunës.

### **Neni 16**

#### **Financimi i aktiviteteve**

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale, mund të financohen si vijon:
  - 1.1 Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
  - 1.2 Nga komuna;
  - 1.3 Nga donatorët;
  - 1.4 Me financim të përbashkët.

### **Neni 17**

#### **Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës me vendim të veçantë nga Kuvendi i komunës.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative të komunës.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

4. Kompensimi bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit sipas nenit 14, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje.
5. Numri i mbledhjeve me kompensim është gjashtë (6), ndërsa pa kompensim mund të mbahen edhe me shumë.

**Neni 18**  
**Mos përmbushja e përgjegjësi**

Këshilli lokal mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga organet e komunës në këshillin lokal.

**Neni 19**  
**Dispozitat kalimtare**

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e ligjit, udhëzimit administrativ apo statutit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr.03/16 për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillave Lokale e Komunës së Vushtrrisë e datës 28.7.2016.

**Neni 20**  
**Përgjegjësia për zbatim**

20.1. Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Administratë.

20.2. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

**Neni 21**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe ueb-faqen e komunës.

**Data:** \_\_\_/\_\_\_/2022  
**Komuna e Vushtrrisë**

**Kryesuesja e Kuvendit**

**Melihate Basholli Latifi**










Republika e Kosovës



Komuna Vushtri

<b>DATE:</b>	<b>27.06.2022</b>
<b>PËR:</b>	<b>znj. Hava Mlinaku, Drejtoreshë e Drejtorisë për administratë komunale</b>
<b>CC :</b>	
<b>NGA:</b>	<b>Nga komisioni për emërtimin e zonës urbane:</b> 1. Arlind Gogolli  2. Leonora Gërguri  3. Fatmire Cecelia  4. Izet Miftari  5. Egzon Haradinaj 
<b>TEMA :</b>	<b>Propozimi për ndarjen e lagjeve në qytet</b>

Komisioni pas pesë mbledhjeve të mbajtura, ka analizuar në detaje ndarjen e zonës urbane të Vushtrrisë, si dhe propozimet për emërtimin e tyre.

Bazuar në Rregulloren e miratuar nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal që e rregullon këtë fushë, komisioni propozon që qyteti i Vushtrrisë të ndahet në shtatë (7) zona, me këto emërtime:

1. QENDRA
2. KALAJA
3. URA E VJETËR E GURIT
4. VICIANA
5. SILNICA
6. DARDANIA dhe
7. ILIRIA

Ndarja e përgjithshme e zonave është propozuar nga komisioni sipas hartës të bashkangjitur këtij propozimi. Ndërsa, specifikat i përfundon Drejtoria e urbanizimit.



Datë/a:	28.06.2022
Referenc-ë:	
Për/Za/To:	Drejtoria e Administratës
Nga/Od/From:	Komisioni për emërimin dhe caktimin e kufijve të lagjeve urbane të Vushtrrisë Arlind Gigolli _____ Leonora Gërguri _____ Fatmire Cecelia _____ Izet Miftari _____ Egzon Haradinaj _____
Tema/Subjektat/Subject:	Propozimi për ndarje e Zonës Urbane të qytetit të Vushtrrisë në 7 lagje

Të nderuar,

Komisioni ka bërë propozimin për ndarjen e lagjeve urbane në Komunën e Vushtrrisë në 7 (shtatë) lagje:

Qendra

Kalaja

Ura e Vjetër e Gurit

Viciana

Silnica

Dardania

Iliria

- Lagja Qendra Kufizohet me rrugët "Faruk Beqiri", "Enver Musa", "Zenullah Begu", segmenti i rrugës "Vesli Klark", "Hasan Prishtina" dhe Sheshin "Adem Jashari", kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë "Shefki Dallku", "Hys Popova", "Burim Muli", "Arsim Muzaqi", "Sulejman Vokshi", "Shtatë Shtatori", "Muharrem Berisha", "Ahmet Selaci", "Jakup Jakup Badivuku", "Galip Badivuku", "Shemsi Istrefi", "Rexhep Tërllabuqi", "Aziz Zhilivoda", "Rrahmon Selaci", "Isa Boletini", "Faruk Sunguri", "Bislim Bajgora" dhe rruga "Basri Beqiri".

- Lagjja Kalaja Kufizohet me rrugët "Xhavit Mulaku", "Dëshmorët e Kombit", Sheshin "Adem Jashari", rruga "Hasan Prishtina", "Gjergj Kastrioti Skenderbeu", "Ana Lin" dhe "Rrustem Hyseni Historiani" kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë "Ekrem Mulaku", "Murat Rashica", "Gjon Buzuku", "Bedri e Nebih Uka", "Burhan Badivuku", "Bedri Bajgora", "Hamdi Ferat", "Ukshin Kovaqica", "Ismajl Parduzi", "Shahin Krasniqi", "Rexhep Musa", "Kruja", "Ali Pashë Tepelena", "Ridvan Qazimi", "Marin Berleti", "Pandeli Sotiri", "Udha e Shkronjave", "Hoxhë kadri Prishtina", "Shemë Nallbani", "Gëzim Rama", "Xhevat Jusufi", "Sali Zeka". "Ismajl Qemajli", "Halit Çuka", "Zeqir Kamerolli", "Ramadan Fazliu", "18 Prilli", "Ferat Novolani", "Luan Haradinaj", "Arsim Rrustolli", "Haxhi Zeka", "Ali Buqinca", "Çameria", "Enver Rrustolli", "17 Qershori", "Jeronim De Rada", "Nazmi Ispahiu", "Qamil Zeqiri", "Shefqet e Shefki Popova", "Hakif Zejnullahu", "Avni Rrustemi", "Jakup Ceraja", "Aziz Mehmeti", "Mursel Billata", "Hajzer Jashari", "Edmond Hoxha", "Shemsi Ahmeti", "Bahri Ferizi", "Naser Hajrizi" dhe rruga "2 Korriku".
- Lagjja Ura e Vjetër e Gurit Kufizohet me rrugët "Gjergj Kastrioti Skenderbeu", "Vesli Klark", segmentin e rrugës "Kadri Zeka", "Nazmi Aliu", "Viciane", "Adnan Shyti", "Hamdi Gashi", "Rasim Pasoma" dhe segmentin e rrugës "Mbretëresha Teutë", kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë "Blerim Zuqaku", "Avni Saraçi", "Bedri Pejani", "Xhevat Uka", "Ferit Mulaku", "Bahtir Perçuku", "Mensur Gërguri", "Rushit Strofci", "Martirët Grabanica", "Hamdi Gashi", "Qamil Haziri", "Sahit Avdulli", "Hazir Kolla", "Lulzim Jashari", "Shaban Tahiri", "Durrësi", "Ramadan Kastrati", "Hasan Tiku Shabani", "Mustafë Januzi", "Mehmet Bivolaku", "Paria e Drenicës", "Vehbi Hetemi", "Hazir Gjaka", "Ismet Haliti", "Agim Islami", "Sefer Dubovci", "Asllan Xhemajli" dhe "Vëllezrit Tahiri".
- Lagjja Viciane Kufizohet me rrugët "Tahir Sinani", "Çanakkala", "Mehdi Zabeli", segmentin e rrugës "Lumni Surdulli" dhe "Niman Ferizi", rrugën "Faruk Beqiri" dhe "Xhavit Mulaku", kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë "Indrit Cara", "Daut Imeri", "Martirët e Lirisë", "Dëshmorët e Kombit", "Shaban Polluzha", "Ajet Gërguri", "Shkolla e Parë Shqipe", "Kongresi i Manastirit", "Ferat Muja", "Sadri Kapiti", "Selmon Kostanica", "Qemajl Shaqiri", "Dituria", "Avni Klinaku", "Qerim Qerimi", "Ahmet Uka", "Balli Kombëtar", "Agim Zeqiri", "Bajram Latifi", "Eset Ibrahim", "Shaban Krasniqi", "Hajriz Musa", "Liman Bajram Hasani", "Helge Onsrud", "Toplica", segment i rrugës

"Lumni Surdulli", rruga "Ejup Kasumi", "Kadri Dushi", segmenti i rrugës "Vëllezërit Melenica", rruga "Ibish Dervishi", "Jeton Tërrstena", "Enver Tahiri", "Shaban e Xhevat Musa", "Sherif Dibrani", "Gani Muli", "Musa Hajdini", "Ekrem Isufi", "Selim Bislimi", "Sherif Kolla", "Rafet e Burim Rrahmani", "Isuf Mehana", "Halit Salihu", "Hamdi Hajrizi", "Hamdi Krasniqi", "Jashar Jashari", "Burim Hoxha", "Mehdi Haziri", "Rexhep Podvorica", "Abit Kolla", "Mehdi Musliu", "Musë Hajrizi", "Xhemajl Mehmeti", "Dardania", "Mehmet Akifi".


- Lagjja Silnica Kufizohet me rrugët "Enver Musa", Segmentin e rrugës "Lumni Surdulli", "Zenullah Begu", "Kadri Zeka", "Hamit Hyseni" dhe "Niman Ferizi" "Lidhja e Lezhës", kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë "Sejdi Beqiri", "Rifat Galica", "Mursel Istrefi", "Mehmet Konjuhi", "Koshtova", "Mujë Ulqinaku", "Mustafë Shyti", "Halit Mikullovc", "Shaban Mlinaku", "Fazli Shabani", segmenti i rrugës "Lidhja e Lezhës", rruga "22 Maji", "Bajram Miftari", "Mic Sokoli", "Bajram Curri", "Zymer Haliti", "Rrahim Syla", "Zymer Haziri", "Adem Ademi", "Fehmi Tahir Istrefi", "Bekim Zenuni", "Mursel Hyseni", segmenti i rrugës "Isak Halili", rruga "Hamit Zuqaku", "Mehmet Xhema", "Isë Mehmeti".
- Lagjja Dardania Kufizohet me rrugët "Tahir Sinani", "Çanakkala", "Rrustem Hyseni Historiani", segmentin e rrugës "Ukshin Hoti", rrugën "31 Maji", segmentin e rrugës "Mehmet Kasumi", rrugën "Vëllezërit Feka", "Greva e Minatorëve" dhe segmentin e rrugës "Bahri Kuqi". Kurse në kuadër të lagjes përfshihen këto rrugë "Patrioti", "Halit Konjuhi", "Zëri i Kosovës", "Qazim Ademi", "Hoxhë Brezhnica", "Njazi Badivuku", "Miftar Shaqiri", "Bedri Krasniqi", "Avni Feka", "Sahit Krasniqi", "Remzi Aliu", "Fatmir Krasniqi", "17 Shkurti", "Behxhet Aliu", "Martirët e Zogajve", "Muharrëm Parduzi", "Bekim Berisha Abeja", "Shala", "Rexhë e Fadil Selmani", "Ragip Musliu", "Rasim Istrefi", "Qazim Jashari", "Xajë Jashari", "Shefqet e Behxhet Cimili", "Lufti Musiqi", "Lah Izmak", "Fexherije Veseli Gërxhaliu", "Sami Lahu", "Shefki Grabanica", "Zenun Gjocaj", "Hajzer Neziri", "Rifat Banjska", "Muhamed Rashica", "Sadri Klinaku", "Sherif Galica", "Bajram Gashi", "Vëllezërit Muzaqi", "Fehmi Tërrnave", "Nazif Ismajli", "Xhemajl Hyseni", "Shkodra", "Abaz Jashari", segmenti i rrugës "Rrahman Krasniqi", rruga "Hajrë Hajra", "Tivari", "Fetah Hyseni", "Hoxhë Beqir Rashica", "Naip Rashica", "Rizah Rashica", "Avni e Bedri Rashica", "Naman e Zylfije Konoviku", "Zylfije Krasniqi", "Avdyl Mehmeti", "Aziz Halili", "Musli e Selim Drevinja", "Basri e Ali Hyseni", "Hasan

Rashica", "Igballe Prishtina", "Istref e Rexhep Haziri", "Fadil Beqiri", "Adnan Bunjaku", "Osman e Shaban Bunjaku", "Faik Konica", "Enver e Zymer Prronaj", "Deli e Ali Rashica", "Musli Gërguri", "Hysen e Xhevdet Hyseni", "Vëllezërit Zeqiri", "Zeqir Rashica", "2 Maji", "Idriz Kurti", "Halim Behrami", "Hazir Muli", "Hashim Kolla", "Hazir Gërguri", "Kadri Bajra", "Fatmir Ejup Gërxhaliu", "Qazim Ferati" dhe "Xhemajl Gërxhaliu".

- Lagjja Iliria kufizohet me segmentin e rrugës "Bahri Kuqi" dhe "Mbretëresha Teutë" e rrugën "Ana Lin". Kurse në kuadër të lagjës përfshihen këto rrugë "Driton Merovci", "Selim Muzaqi", "Gjergj Fishta", "Selman Miftari", "Arsim Tahiri", "Ferat Hasani", "Sadri Jetullahu", "Brukseli", "Beshir Krasniqi", "Fitim Dibrani", "Sadik Idrizi", "Sinan Haziri", "Lutfi Islami", "Abedin Ferizi", "Trepça", "Idriz Hasani", "Mustafë Çuka", "Nysret Zymberi", segmenti i rrugës "Boletini", rruga "Azem Bejta", "Shotë Galica", "Adem Demiraj", "Sefedin Morina", "Jonuz Jashari", "Sabri Behrami", "Imer Sheshivari", "Demir Halili", "Naim Zahiti", "Muhamet Idrizi", "Ejup Munishi", "Nazmi Hyseni Popova", "Hajriz Halili", "Milaim Salihu", "Mursel Krasniqi", "Veli Xhafa", "Mehmet Pashë Zogu", "Ilaz Kodra", "Isë Mërnica", "Shefqet Karakashi", "Halit Merovci", "Hilmi Rrustemi", "Selim Mërnica", "Jakup Saraçi", "Shaip Azemi", "Ramë e Imrane Blakaj", "Bajram Aliu", "Rifat Krasniqi", "Ahmet Hajra", "Beqir Hyseni", "Mirusha", "Nezir Imeri", "Haxhi Ibrahim", "Ismail Galica", "Selim Ferati" dhe segmenti i rrugës "Sekine Maxhuni".

**ZONA URBANE E QYTETIT TË VUSHTRISË**

**PROPOZIMI PËR NDARJEN E LAGJEVE**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna Vushtrri  
Opstina Vucitrn - Municipality of Vushtrri

**Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë**

**Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë** *Ferit Idrizi*

**Hartues: Fortuna Krasniqi, Drejtoreshë e DUMM-së** *Fortuna Krasniqi*

**Lënda: Propozim-Vendim**

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika "d" lidhur me nenin 7 pika "s" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr: 03/L-040/2008, neni 41.2 , pika "9" të statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës dhe në nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal në mbledhjen e mbajtur me 30.06.2022, merr këtë:

#### V E N D I M

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike para lokaleve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e gastronomisë për më pak se një vit nga data 03.01.2022 deri më datën 28.12.2022
2. Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja e këtyre veprimtarive të cilat operojnë në gjendje jo të mirë ekonomike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Inspektime.
4. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli Latifi**


**Kryesuese e Kuvendit**

## ARSYETIM

Duke marrë parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike të këtyre veprimtarive si dhe bazuar në krizën ekonomike, konsiderojmë që është e nevojshme që këto veprimtari të lirohen nga pagesa e taksës komunale për periudhë kohore për më pak se një vit.

Me respekt!

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



Fortuna Krasniqi Spahiu